amfALBANIA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

# '09

## RAPORT VJETOR



amf ALBANIA

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

# '09

## raporti vjetor

© 2010
**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.
Adresa : Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10,  P.O.Box. 8363, Tiranë
Tel : +355-4-2251355  / 6
Faks : +355-4-2250686
E-mail : amf@amf.gov.al
URL : www.amf.gov.al



# Përmbajtja


**Fjala Përshëndetëse e Kryetares** 6

**PJESA I**
**AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI** 7

**Kapitulli 1**
**Organizimi i AMF**

1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore 7
1.2 Menaxhimi dhe organizimi 8
1.3 Buxheti dhe financimi 15

**Kapitulli 2**
**Aktiviteti i AMF** 17

2.1 Aktiviteti rregullues 17
2.2 Aktiviteti licencues 25
2.3 Aktiviteti mbikëqyrës 33
2.4 Teknologjia e informacionit 43
2.5 Bashkëpunimi institucional 49
2.6 Integrimi Evropian 53
2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca 56

**Kapitulli 3**
**Mbrojtja Konsumatorit** 60

**PJESA II**
**TREGJET E MBIKËQYRURA** 63

II.1 Tregu i sigurimeve, zhvillimet, tendencat 63
II.2 Tregu i letrave me vlerë 70
II.3 Tregu i pensioneve private vullnetare 73

**SHTOJCA** 76

# Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF

*Zonja dhe Zotërinj,*

Kam kënaqësinë të sjell pranë jush Raportin Vjetor 2009 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe një panoramë të aktiviteteve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në funksion të përballimit me sukses të sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare.

Viti 2009 ishte një vit me zhvillime të rëndësishme në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes dhe konsolidimit të legjislacionit rregullues të tregjeve financiare jo-bankare. Veprimtaria e AMF-së është udhëhequr nga misioni i saj themelor, që është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi, e lidhur ngushtë me stabilitetin financiar të operatorëve të mbikëqyrur.

Në kushtet e krizës financiare globale, është ndjekur një strategji e kujdesshme për monitorimin, parandalimin dhe reagimin ndaj efekteve negative të saj në tregun financiar jo-bankar nën juridiksionin e AMF-së. Në përputhje me këtë strategji, janë evidentuar risqet me ekspozim më të lartë ndaj efekteve të krizës ndërkombëtare duke konsideruar skenarët e mundshëm, si dhe reagimin përkatës. Janë orientuar shoqëritë e sigurimit drejt masave për mbrojtjen ndaj risqeve me ekspozim më të madh, janë kërkuar raportime më të shpeshta dhe të detajuara nga tregu dhe institucione të tjera shtetërore, në lidhje me të dhënat financiare, portofolin e investimeve dhe risqet madhore, si dhe janë zhvilluar takime në kuadër të Grupit të Stabilitetit Financiar, pjesëmarrës të të cilit janë AMF, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, për të marrë në konsideratë situatën dhe koordinimin e aktiviteteve.

Forcimi i mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare gjatë vitit 2009 është konkretizuar me një sërë projektesh ligjore, si miratimi i katër ligjeve të reja e një sërë akteve nënligjore në të gjitha fushat e mbikëqyrura, duke kurorëzuar me sukses një punë të gjatë e intensive në forcimin e kuadrit rregullator dhe angazhimet e institucionit drejt harmonizimit të legjislacionit me direktivat e BE-së. Angazhimi dhe puna e institucionit për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga MSA, ka vijuar me kontributin e dhënë gjatë plotësimit të pyetësorit të BE-së për marrjen e statusit kandidat të vendit tonë. Zhvillimi i metodologjive e koncepteve të reja të mbikëqyrjes financiare, arkitektura e re në sigurime, të mbështetura me një sërë produktesh të teknologjisë e informacionit, si qendra e të dhënave të dëmeve motorike krahas asaj të shitjes e raportimit në kohë reale të policave motorike, janë të tjerë hapa cilësorë në konsolidimin e mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare.

Bashkëpunimi ndërkufitar me organizatat ndërkombëtare e institucionet homologe ka hyrë në një fazë të re me nënshkrimin e dy MoU-ve mjaft të rëndësishme: ajo multilaterale e IOSCO-s (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Letrave me Vlerë) si dhe me FMA-në (Autoriteti Rregullator Mbikëqyrës i Austrisë) për fushën e sigurimeve.

Mbrojtja dhe edukimi financiar i konsumatorit mbeten prioritete strategjike të AMF-së. Vendosja e numrit jeshil në faqen zyrtare të internetit është një tjetër hap konkret që ndërmerret në funksion të mbrojtjes së konsumatorit. Gama e gjerë e informacionit të publikuar dhe transparenca në çdo aspekt e veprimtarisë së AMF-së dhe tregjeve të mbikëqyrura, synojnë informimin dhe edukimin e vazhdueshëm të konsumatorit. Realizimi i projekteve dhe objektivave do të ishte i pamundur pa kontributin dhe punën e palodhur të stafit, të cilin gjej rastin ta falënderoj dhe të shpreh bindjen se kontributi i tyre i vlefshëm do të vazhdojë në arritjen e objektivave dhe konsolidimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare jo-bankare. Gjithashtu, dëshiroj t'ju përcjell një falënderim të veçantë kolegëve të Bordit të AMF-së për angazhimin e tyre të plotë në arritjen e objektivave për vitin 2009 dhe nxitjen e vazhdueshme të punës së institucionit tonë në të gjitha drejtimet.

Uroj që ky raport të jetë me interes për lexuesin dhe ai të gjejë në të informacionin e dëshiruar.



**Elisabeta GJONI**

*Kryetare*

# PJESA I
# AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI



## Kapitulli 1
## Organizimi i AMF

- *Mbrojmë konsumatorët*
- *Promovojmë tregjet*
- *Zbatojmë ligjin*

### 1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03. 07. 2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. AMF është institucion qendror, i pavarur nga ekzekutivi dhe raporton në Kuvend mbi aktivitetin e ushtruar gjatë vitit paraardhës.

**SUBJEKTE të mbikëqyrura**

- Shoqëritë e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës
- Shoqëritë e risigurimit
- Ndërmjetësit e sigurimeve
- Bursa dhe tregjet e tjera të letrave me vlerë
- Ndërmjetësit financiarë të letrave me vlerë
- Shoqëritë administruese
- Fondet e investimit dhe shoqëritë e investimit
- Fondet e pensionit
- Kujdestar, Depozitar dhe Regjistrar i letrave me vlerë
- Profesionistë të fushave përkatëse

**Misioni**

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

**Objektivat**

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve
- Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare
- Sigurimi i respektimit të ligjit

**Funksionet themelore të AMF-së**

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja e:

- tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari,

- tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg,
- tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg,
- veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen "tregje financiare jo-bankare".

Funksionet bazë rregullative-mbikëqyrëse të AMF-së, parashikohen kryesisht në nenet 2 dhe 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe përkatësisht në ligjet e sektorëve të mbikëqyrur (Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar").

Kuadri i ri ligjor në fushën financiare jo-bankare ka konsoliduar më shumë funksionet rregullative dhe mbikëqyrëse të AMF-së. Këto ligje përmbajnë dispozita të veçanta, të cilat japin një përcaktim më të qartë të funksioneve apo kompetencave që ka Autoriteti.

## 1.2 Menaxhimi dhe organizimi

### Bordi i AMF-së

Bordi i AMF-së është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i AMF-së është organ kolegjial, që përbëhet nga shtatë anëtarë, tre prej të cilëve janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë dhe kryejnë përkatësisht funksionet e kryetarit dhe dy nënkryetarëve.

Të gjithë anëtarët e Bordit mandatohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afate të shkallëzuara, që përcaktohen nominalisht. Bordi i AMF-së, ka përbërjen e mëposhtme:

| | | | |
|---|---|---|---|
| ▪ Elisabeta GJONI | *Kryetare* | ▪ Diana LAMANI | *Anëtare* |
| ▪ Ermela GUXHOLLI | *Nënkryetare* | ▪ Miranda RAMAJ | *Anëtare* |
| ▪ Keler GJIKA | *Nënkryetar* | ▪ Saimir SALLAKU | *Anëtar* |



Gjatë vitit 2009, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka zhvilluar 12 mbledhje, ku janë marrë gjithsej 118 vendime në përmbushje të funksioneve rregullative, funksioneve mbikëqyrëse dhe atyre institucionale. Vendimet e Bordit kanë mundësuar realizimin e një mbikëqyrje efektive të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe atij të pensioneve private. Vendimet e lidhura me funksionet mbikëqyrëse përshijnë masa korrektive dhe sanksione, që kanë synuar eliminimin e shkeljeve dhe përmirësimin e tregut financiar jo-bankar. Vendime me rëndësi, në kuadër të rregullimit të mëtejshëm të tregut kanë qenë dhe ato për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, vlerësuesve të dëmeve, brokerave fizikë dhe shoqërive të brokerimit. Vendimet e Bordit kanë trajtuar edhe anën institucionale të AMF-së dhe kanë mbështetur iniciativa të ndryshme për zhvillimin dhe promovimin e tregjeve të mbikëqyrura.

Bordi, gjatë vitit 2009, ka miratuar 12 rregullore kryesisht në fushën e letrave me vlerë dhe sigurimeve. Aktiviteti i Bordit gjatë vitit 2009 ka ndihmuar në përmbushjen e misionit të AMF-së në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare dhe sigurimit të respektimit të ligjit.

### Kompetencat Kryesore të Bordit të AMF-së

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie.
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij.
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj.
4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore.
5. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiar jo-bankar.
6. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.
7. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët.
8. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit.
9. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e njoftimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit.
10. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jo-bankar.
11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jo- bankare.
12. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e tregut financiar jo-bankar.
13. Miraton manualet e inspektimit.
14. Sipas ligjit, merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin.



**Elisabeta Gjoni**
Kryetare



**Ermela Guxholli**
Nënkryetare



**Keler Gjika**
Nënkryetar



**Diana Lamani**
Anëtare



**Miranda Ramaj**
Anëtare



**Saimir Sallaku**
Anëtar

15. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-së.
16. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit.
17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.
18. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të AMF-së.
19. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e stafit.

## Struktura organizative e AMF-së

Struktura e Autoritetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Bordit të AMF-së. Edhe gjatë vitit 2009, Autoriteti vazhdoi të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit nr. 98, datë 30.04.2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare".

Struktura aktuale e organizimit të Autoritetit mundëson një hierarki të përshtatshme për stafin e AMF-së dhe lejon mbulimin e të gjitha funksioneve që AMF kryen. Organizimi në katër departamente kryesore dhe dhjetë drejtori krijon një ndarje të drejtë të përgjegjësive dhe lehtëson komunikimin midis njësive përbërëse.

Organika e AMF-së e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë është 58 punonjës, por Ligji nr. 10025, datë 27.11.2008 "Për Buxhetin e vitit 2009", e kufizoi në 45 numrin e punonjësve të institucionit edhe për vitin 2009.



AMF - Departamenti i Çështjeve Juridike



AMF - Drejtoria e Analizës dhe Raportimit

Në vijim të ndryshimeve strukturore nën sugjerimet e VKM nr. 901, datë 19.12.2007 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve, nëpunësve civilë, nëpunësve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura", të ndryshuar, Autoriteti, gjatë gjithë vitit 2009, ka paraqitur në mënyrë të përsëritur pranë Kuvendit të Shqipërisë, projektvendimin "Për një ndryshim të Vendimit nr. 98, datë 30. 04. 2007, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", në të cilin përfshihet dhe propozimi për miratimin e kategorizimeve për pozicionet e punës "Përgjegjës Sektori" dhe "Specialist". Zbatimi i vendimit të lartpërmendur ndikon negativisht në nivelet e pagave për këto pozicione, si dhe sistemin e pagave në tërësi të stafit të AMF-së.

Pritet një reagim zyrtar nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me projektvendimin e paraqitur nga Autoriteti.



### Struktura sipas njësive




### Struktura sipas profesionit




### Struktura e stafit teknik të AMF sipas grupmoshës





Stafi i AMF-së 2009

## Politikat e Burimeve Njerëzore

Qëllimi kryesor në fushën e Burimeve Njerëzore është thellimi i profesionalizmit të punonjësve dhe motivimi i tyre për arritjen e objektivave të institucionit.

Në planin afatshkurtër vëmendja e sektorit të burimeve njerëzore u përqëndrua në:

- nxitjen dhe motivimin e punonjësve në përmbushjen e detyrave të tyre funksionale
- trajnimin e mëtejshëm të punonjësve
- punësimin e burimeve njerëzore sa më cilësore

Aplikimi i sistemit të vlerësimit të arritjeve individuale në punë, ka ndikuar në nxitjen dhe motivimin e punonjësve në funksion të rritjes së efektivitetit në punë.

## Procesi i rekrutimit

Politika e punësimit të burimeve njerëzore në Autoritet, edhe për vitin 2009, ka pasur prioritet punësimin e burimeve sa më të afta njerëzore, duke tentuar përzgjedhjen e kandidatëve me aftësitë më të mira profesionale, të diplomuarve me rezultate të larta, me aftësitë e duhura komunikuese, si dhe përkushtim e respektim të rregullave të institucionit. Këto kritere kanë sjellë rritje cilësore të produktivitetit të punës, si në nivelet e specialistëve ashtu dhe ato menaxheriale.



Politika e rekrutimit në kuadër të nismës “brain-gain”, i ka ofruar hapësirat e nevojshme dhe të rinjve të diplomuar jashtë vendit.

**Struktura e stafit teknik sipas diplomimit**




## Kualifikimi profesional

Në drejtim të kualifikimit profesional, është ruajtur përgjithësisht linja që synon specializimin e punonjësve në profilin që ata punojnë.
Gjatë vitit 2009, vëmendja është përqendruar në trajnimet afatshkurtra, brenda e jashtë vendit, duke shfrytëzuar marrjen e përvojave më të mira profesionale mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore, Këshilli i Evropës, FSVC, si dhe shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve IAIS, IOSCO, IOPS, apo dhe rregullatorëve si NAIC (Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj.

Shifrat tregojnë se në vitin 2009, rreth 75% e stafit teknik të AMF-së ka marrë pjesë aktive në seminare, trajnime, e konferenca të lidhura me fushat respektive.

AMF, në funksion të politikës për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale, gjatë vitit 2009, ka nxitur dhe financuar specializime



Gjatë zhvillimit të testimit

## Programi Kualifikues i Aktuarëve

Në mbështetje të politikës së Autoritetit për trajnimin, kualifikimin e punonjësve me synim përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së punës, AMF, në bashkëpunim me FSVC (Financial Services Volunteer Corps) dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve, bëri të mundur organizimin e programit kualifikues të aktuarëve. Kursi bazohet në praktikat më të mira të Institutit të Aktuarëve në Londër.

Qëllimi i këtij programi është dhënia e njohurive më thelbësore në shkencën e aktuaristikës, me synim përgatitjen e pjesëmarrësve për aplikimin e metodave dhe teknikave të përparuara aktuariale në drejtim të sigurimit të jetës, produktet e jo-jetës, skemës së pensioneve, çështje të cilat paraqesin rëndësi të veçantë në aktivitetin dhe funksionet themelore të AMF-së.

afatgjata të punonjësve të saj, veçanërisht në drejtime që lejojnë realizimin me sukses të detyrave dhe objektivave kryesorë. Kështu, në muajin nëntor 2009, AMF realizoi mbështetjen financiare të disa punonjësve për ndjekjen e kursit të trajnimit në fushën e aktuaristikës, kurs i cili organizohet nga FSVC dhe bazohet në praktikat më të mira të Institutit të Aktuarëve në Londër.

## Auditi i brendshëm

### Funksioni

Njësia e Auditit të Brendshëm e kryen funksionin e saj në zbatim të rregullave të përcaktuara në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".

### Aktiviteti

Njësia e Auditit të Brendshëm të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2009, ka realizuar programin vjetor të miratuar nga Bordi, i cili përcaktonte përfundimin e 11 auditimeve. Aktiviteti i Auditit të Brendshëm kryhet nga një specialist i auditit. Çdo procedurë auditimi është realizuar mesatarisht në 23 ditë pune.

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm, janë raportuar periodikisht në Bordin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare rezultatet e auditimeve të kryera. Gjatë vitit 2009, Njësia e Auditit, ka dhënë 11 rekomandime, të cilat janë realizuar ose janë në proces realizimi.

## Arkiv - Protokolli

### Funksioni dhe aktiviteti

Zyra e Arkiv - Protokollit e kryen funksionin e saj në zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".

E gjithë korrespondenca zyrtare e Autoritetit, trajtohet në këtë zyrë, e cila konkretisht për vitin 2009 ka përpunuar rreth 2055 praktika, ku rreth 50% e numrit të tyre janë përgjigje të praktikave drejtuar AMF-së nga palët e interesit dhe pjesa tjetër, kryesisht i janë drejtuar institucioneve të ndryshme nga të cilat është kërkuar informacion nga ana e AMF-së. Fluksi i korrespondencës gjatë vitit 2009, ashtu siç është vërejtur dhe më parë, ka tendencë rritjeje në periudhat e mbylljes së tremujorëve e pikërisht, kur shtohet komunikimi shkresor midis Autoritetit dhe subjekteve të mbikëqyrura të licencuara. Përveç komunikimit elektronik, brenda institucionit ka funksionuar edhe korrespondenca e brendshme nëpërmjet memove, raporteve dhe relacioneve. Kjo lloj korrespondence ka



të bëjë me komunikimet brenda njësive organizative, si pjesë përbërëse të strukturës së institucionit. Gjatë vitit 2009 rezultojnë 601 komunikime të tilla.

## 1.3 Buxheti dhe financimi

Për garantimin e funksionimit normal të aktivitetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" përcakton llojet e të ardhurave në favor të buxhetit të Autoritetit. Në respektim të kërkesave ligjore, Autoriteti, gjatë vitit 2009 ka siguruar burimet financiare për përballimin e shpenzimeve të funksionimit dhe shpenzimeve për investime.

Viti 2009, shënoi financimin e aktivitetit të AMF tërësisht nga burimet e veta. Pavarësisht se buxheti i shtetit akordoi për këtë vit, 2 milion lekë fonde për investime, Autoriteti për shkak të mos përdorimit të tyre, i riktheu këto fonde brenda 6-mujorit të parë në buxhetin e shtetit.
Hartimi i pasqyrave financiare të Autoritetit dhe mbajtja e kontabilitetit, edhe për vitin 2009, është bërë në përputhje me VKM nr. 248, datë 10.04.1998, ndryshuar me VKM nr. 25 datë 20.01.2001 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale dhe njësive që varen prej tyre" si dhe Udhëzimit nr. 26, datë 27.12.2007 të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore".
Të ardhurat dhe përdorimi i tyre, për vitin 2009, paraqitet si më poshtë:

**Tabelë 1: Burimet e fondeve të AMF-së**

| *Emërtimi* | **Vlera në Lekë** |
|---|---|
| 1. Të ardhura nga veprimtaria | **127,473,058** |
| 1.1 Të ardhura nga kontributet e shoqërive të sigurimit | 115,195,709 |
| 1.2 Të ardhura nga institutet e pensioneve private | 210,637 |
| 1.3 Të ardhura nga subjektet që operojnë në tregun e letrave me vlerë | 1,978,000 |
| 1.4 Të ardhura nga licencime | 1,335,270 |
| 1.5 Të ardhura nga gjoba, konvertime dhe interesa bankare | 8,753,442 |
| 2. Rezultati i mbartur nga vitet e mëparshme | **19,847,773** |
| 3. Financime të mbartura për investime në proces | **35,658,956** |
| **TOTALI** | **182,979,787** |

**Tabelë 2: Përdorimi i fondeve të AMF-së**

| *Emërtimi* | **Vlera në Lekë** |
|---|---|
| 1. Shpenzime funksionimi | **86,578,350** |
| 1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore | 52,855,313 |
| 1.2 Shpenzime operative | 33,723,037 |
| 2. Investime | **13,224,268** |
| 3. Investime në proces | **31,059,313** |
| 4. Të ardhura të regjistruara për periudhat e ardhshme | **32,270,083** |
| 5. Për t'u derdhur në Buxhetin e Shtetit | **19,847,773** |
| **TOTALI** | **182,979,787** |

Siç tregohet nga të dhënat e tabelave të mësipërme, në të ardhurat e realizuara nga Autoriteti për vitin 2009, peshën kryesore, rreth 90.36% e zënë kontributet e paguara nga shoqëritë e sigurimit. Ndërkohë, meqenëse aktiviteti në tregun e pensioneve dhe të letrave me vlerë është ende në fazat fillestare të zhvillimit, kontributet e këtyre tregjeve në buxhetin e AMF-së janë tepër të vogla. Një pjesë të fondeve të buxhetit të AMF-së për vitin 2009, e përbëjnë fondet e mbartura nga viti i mëparshëm, si fonde për të financuar investimet në proces. Punimet për rikonstruksionin e ambienteve të reja për akomodimin e stafit të AMF-së përfaqësojnë investimet në proces të filluara nga viti i mëparshëm dhe që parashikohet të vazhdojnë gjatë vitit 2010.

Shpenzimet e funksionimit, ku përfshihen shpenzimet për paga dhe shpërblime, si dhe shpenzimet operative, gjatë vitit 2009, përfaqësojnë rreth 68% të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria e vitit 2009. Shpenzimet për investime janë përqendruar në krijimin e kushteve të punës për stafin e AMF-së (punimet për ndërtesën si investime në proces dhe të mbartura) dhe në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike, me synim përmirësimin e rolit mbikëqyrës të Autoritetit në tregun financiar jo-bankar.



# Kapitulli 2
# Aktiviteti i AMF

## 2.1 Aktiviteti rregullues

Një ndër angazhimet kryesore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2009 ka qenë miratimi i legjislacionit rregullues të fushës së shërbimeve financiare jo-bankare. Gjatë vitit 2009, në kuadër të përmirësimit të akteve ligjore ekzistuese dhe përafrimit të tyre me Direktivat e BE-së, AMF ka hartuar 4 ligje të reja:

- Ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
- Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar";
- Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive";
- Ligjin nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore".

**Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"**

Ky ligj ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm dhe përfshirjen si të detyrueshme të disa produkteve të reja të sigurimit në sektorin e transportit. Ligji është hartuar në një kohë kur tregu i sigurimeve është zhvilluar me shpejtësi dhe ka si qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Ligji për sigurimin e detyrueshëm në transportin publik është mbështetur në direktivën 72/166/EEC "Për sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjeteve motorike dhe zbatimin e detyrimeve që sigurojnë një përgjegjësi të tillë", Direktivën 84/5/ECC "Për përafrimin e legjislacionit lidhur me sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjetit motorik", amenduar me Direktivat 88/357/EEC, 90/232/EEC, Direktivën 2000/26/EC dhe Direktivën 2005/14/EC.

Pjesë thelbësore e ligjit është mbrojtja e palëve të treta të dëmtuara nga aksidentet dhe e konsumatorëve të policave të sigurimit të detyrueshëm. Gjatë zbatimit të tij prej rreth një viti, ky ligj ka sjellë shumë përmirësime, sidomos në procedurën e trajtimit të dëmeve, pasi është përfshirë dhe trajtuar për herë të parë koncepti i dëmit jo-pasuror ose i ashtuquajtur "dëmi moral" që vjen si pasojë e vdekjeve dhe dëmtimeve shëndetësore të pësuara nga palët në një aksident dhe në aspekte të tjera të trajtimit të dëmeve.

Ligji nëpërmjet krijimit të qendrës së informacionit në sigurime ka mundësuar mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të aksidenteve, duke hedhur bazat për krijimin e një sistemi Bonus Malus në të ardhmen.

Ligji parashikon ndër të tjera edhe zgjerimin e gamës së produkteve të sigurimit të detyrueshëm me dy produkte të reja:

- sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, si dhe;
- sigurimin e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar palës së tretë nga përdorimi i mjeteve të transportit ajror dhe mjeteve lundruese.

**Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"**

Gjatë 2009, në kuadër të zbatimit të detyrave të caktuara nga Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit, Autoriteti ka hartuar Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar". Ky ligj sjell përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensioneve, të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara duke ndryshuar skemën aktuale të funksionimit të kolonës së tretë.

Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, synon përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare në Shqipëri nëpërmjet:

- lehtësimit në planin afatgjatë të kostove sociale, duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- shtimin e nivelit të kursimit të popullatës dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.

Në tërësi dhe në detaje, ligji vendos standardet e nevojshme për administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve private, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit, të nxitet qëndrueshmëria, siguria dhe mirëqeverisja e aseteve të fondit të pensionit.

Ligji ndan konceptin e administrimit të fondit nga vetë fondi i pensionit dhe gjithashtu parashikon lehtësira tatimore, me qëllim nxitjen e shtetasve shqiptarë për të kontribuar në fondet e pensionit vullnetar. Nxitja e pjesëmarrjes është synuar të arrihet duke futur politikën e lehtësirave tatimore sipas modelit EET, që nënkupton tatim vetëm në momentin e marrjes së përfitimit. Shprehimisht, në nenin 88, parashikohet se kontributet e bëra nga punëdhënësi, vetë anëtari dhe çdo kontribues tjetër në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk konsiderohen si të ardhura personale të anëtarit.

Gjithashtu, ligji në dispozita të veçanta parashikon kritere aftësie e përshtatshmërie (fit and proper) të aksionarëve dhe administratorëve të shoqërisë administruese, si dhe dispozita për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre në shoqërinë administruese. Nëpërmjet këtyre parashikimeve synohet rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së personave, të cilët administrojnë kontributet në fondin e pensionit vullnetar.



*Parimet kryesore në thelb të politikës së investimit*

Politikat e investimit të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese janë hartuar në përputhje me parimet e diversifikimit të riskut duke pasur parasysh edhe mësimet nga kriza aktuale financiare botërore. Në këto dispozita rëndësi u është kushtuar përcaktimit të klasave të investimeve të pa lejuara duke shprehur në këtë mënyrë detyrimin e qartë të shoqërisë administruese për të mos investuar në instrumente financiarë, që nuk janë të listuar ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar ose në tregje të tjera të rregulluara nga autoritetet përkatëse.

**Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive"**

Një tjetër akt ligjor i hartuar gjatë 2009, nga AMF, ka qenë Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Ky ligj plotësoi kuadrin ligjor në fushën financiare, fokusuar në tregun e titujve, si një domosdoshmëri që i përgjigjet zhvillimeve aktuale në vend. Ligji synon të krijojë një ambient të përshtatshëm dhe të rregulluar për të nxitur zhvillimin e tregjeve të kapitalit. Vënia në zbatim e këtij ligji, gjatë vitit 2010, do të krijojë hapësirën e duhur për zhvillimin dhe rritjen e tregut të titujve.

Një nga objektivat kryesorë të tij është të sigurojë një mbrojtje efektive të interesave të investitorëve, të cilët nxiten nga ofertat e operatorëve të këtyre sipërmarrjeve. Për këtë qëllim, parashikon ndalimin e promovimit, reklamimit, tregtimit, ose ofertën për shitje të kuotave apo aksioneve të një sipërmarrjeje investimi kolektiv pa autorizimin e AMF-së.

Ligji parashikon krijimin e regjistrit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (regjistri i fondeve) i cili do të mbahet nga Autoriteti dhe është i hapur për publikun. Ky regjistër mundëson një transparencë më të plotë ndaj investitorit në veçanti dhe ndaj publikut të gjerë në përgjithësi. Dispozita të ligjit shmangin konfliktet e mundshme të interesit ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese, përcaktohet që këta subjekte të mos jenë të lidhur me njëri-tjetrin dhe që në veprimtarinë e tyre të mos angazhohen të njëjtët persona.

Ligji gjithashtu përmban dispozita të detajuara në lidhje me ushtrimin e mbikëqyrjes nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ndaj sipërmarrjeve kolektive të investimit, shoqërive administruese të tyre, depozitarëve, etj. Standardet e parashikuara të mbikëqyrjes janë në përputhje me frymën e ligjit të AMF-së dhe standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes në tregjet e titujve.

**Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore"**

Ky ligj u hartua në kuadër të ndryshimeve që pësoi legjislacioni Shqiptar në lidhje me ligjin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht në lidhje me ligjet e reja të aprovuara "Ligji për Titujt" dhe "Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky ligj është përafruar me Direktivën 2004/109/EC "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta" e cila amendon Direktivën 2001/34/EC, Direktivën 2003/71/EC "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar", që amendon Direktivën 2001/34/EC dhe Direktivën 2004/39/EC (MiFID) "Mbi tregjet e instrumentave financiarë".

*Struktura e Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009*

Ligji është i ndarë në tre pjesë kryesore:

- Pjesa e parë përmban dispozitat e përgjithshme, të cilat zbatohen në çdo huamarrje obligacionesh, pavarësisht formës së emetuesit (p.sh shoqëri apo qeveri vendore).
- Pjesa e dytë përmban dispozita të veçanta në lidhje me hua obligacionesh të emetuara nga shoqëri aksionare.
- Pjesa e tretë i referohet huave të obligacioneve që emetohen nga qeverisja vendore.

Struktura e ligjit aktual është në gjendje të lejojë lehtësi të modernizimit të mundshëm, duke përfshirë dispozita për tipe të reja të huave të obligacioneve, sipas tendencave ndërkombëtare dhe kërkesave të tregut vendor.

Në legjislacionin aktual është parashikuar mbrojtja e interesave të aksionarëve të shoqërive tregtare. Për analogji, në këtë ligj janë parashikuar rregulla që mundësojnë mbrojtjen e interesave të mbajtësve të obligacioneve, organizimin dhe vendimmarrjen e tyre në grup për çështje që lidhen me emetimin e obligacioneve, vlerën, interesin dhe maturimin e tyre, çlirimin e kolateraleve apo të garancive që jepen si element sigurie, apo të drejtën për të pasur një agjent. Këto rregulla krijojnë një rregullim ligjor të plotë e praktik për shoqëritë aksionare dhe njësitë e qeverisjes vendore që do të ushtrojnë veprimtari në tregun e obligacioneve.

## Ndryshimet ligjore

### Në fushën e sigurimeve

**Rregullore nr. 36, datë 30.04.2009 "Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike"**

Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurat për raportimin e dëmeve të sigurimeve të detyrueshme përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e qendrës së informacionit të sigurimeve të detyrueshme. Nëpërmjet kësaj rregulloreje mundësohet ngritja e Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik. Kjo qendër ndër të tjera, përmirëson mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve të detyrueshme motorike,



shmang mashtrimet në dëm të konsumatorit, zgjeron tregun dhe ul në maksimum numrin e automjeteve të pasiguruara, duke shmangur kështu konkurrencën e pandershme.

**Rregullore nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"**
Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e trajtimit të dëmeve, që mbulohen nga kontrata e sigurimit të pasagjerëve dhe nga aksidentet në transportin publik, të përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, të përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të avionit për dëme shkaktuar palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i avionit, të përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit lundrues për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

*Risitë që sjell kjo rregullore janë:*

- procedurat dhe përllogaritja e dëmshpërblimit për kontratat e reja të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (sigurimi i pasagjerëve, sigurimi i përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të avionit, sigurimi i përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit lundrues);
- afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, duke përcaktuar limite kohore më të vogla për dëme materiale me shkallë dëmtimi të vogël;
- përmirësimin dhe zgjerimin e metodologjisë së përllogaritjes së dëmit jo-pasuror si risi që ka sjellë ligji i sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihet dëmi biologjik i ndarë sipas grup moshave dhe shkallës së paaftësisë, dëmi moral dhe ekzistencial;
- përmirësimin e metodologjisë së përllogaritjes së dëmit shëndetësor me paaftësi të përkohshme për punë.

**Rregullore nr. 67, datë 27.07.2009 "Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit"**
Kjo rregullore përcakton kriteret dhe kushtet për dhënien dhe tërheqjen e autorizimit të aktuarit, si dhe përcaktimin e detyrave të tij.

**Rregullore nr. 75, datë 28.08.2009 "Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"**
Kjo rregullore përcakton nivelin e primeve dhe të provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përllogaritjen e primeve dhe provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Në rregullore përcaktohet gjithashtu procedura dhe afatet për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të tabelave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

**Rregullore nr. 111, datë 10.12.2009 "Mbi mënyrën e miratimit, financimit dhe administrimit të buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit"**
Rregullorja përcakton mënyrën e miratimit, financimit dhe administrimit të buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

## Në fushën e letrave me vlerë

**Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë"**
Kjo rregullore përcakton kushtet e kryerjes së transaksioneve që lidhen me kujdestarinë e letrave me vlerë të Qeverisë dhe mënyrës së autorizimit të bankave për kryerjen e kësaj veprimtarie.

**Rregullore nr. 22, datë 26.03.2009 "Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH-së"**
Kjo rregullore përcakton rregullat për funksionimin dhe mbikëqyrjen e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, ku përfshihen: bono thesari dhe obligacione.

**Rregullore nr. 41, datë 28.05.2009 "Mbi likuiditetin minimal të shoqërive të brokerimit të letrave me vlerë"**
Kjo rregullore përcakton mënyrën e balancimit të aseteve likuide me detyrimet me afat të shkurtër të shoqërisë së brokerimit, si dhe procedurat e raportimit në Autoritet.

**Rregullore nr. 42, datë 28.05.2009 "Mbi detyrimin e emetuesit për informimin e publikut mbi faktet me rëndësi materiale"**
Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë mënyrën e dhënies dhe të përmbajtjes të informacionit që i duhet dhënë publikut në lidhje me rrethana apo vendime, të cilat përbëjnë fakte me rëndësi materiale, si dhe përcaktimi i rasteve që përbëjnë fakte me rëndësi materiale.

**Rregullore nr. 68, datë 27.07.2009 "Mbi përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare në fushën e letrave me vlerë"**
Kjo rregullore përcakton kërkesat në lidhje me përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare në fushën e letrave me vlerë, si dhe përcaktimin e rrethanave apo marrëdhënieve që krijojnë konflikt interesi.

**Rregullore nr. 74 datë 28.08.2009 "Mbi përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të veprimtarisë tregtare të shoqërive komisionere në letrat me vlerë"**
Kjo rregullore përcakton përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të raportimit të veprimtarisë tregtare të shoqërive komisionere në fushën e letrave me vlerë. Me anë të saj sigurohet që Autoriteti dhe përdoruesit e jashtëm të kenë informacion për pozitën financiare, veprimtarinë tregtare dhe ndryshimet e ndodhura në shoqërinë komisionere.

Ndryshime dhe shtesa në **Rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare"** - miratuar me Vendim Bordi nr. 76, datë 28.08.2009.



Ndryshime në **Rregulloren nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë"** dhe **Rregulloren nr. 22, datë 26.03.2009 "Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë" -** miratuar me Vendim Bordi nr. 79, datë 28.08.2009.

Ndryshime në **Rregullore nr. 17, datë 21.03.2007 "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare"** - miratuar me Vendim Bordi nr. 57, datë 25.06.2009.



Bordi drejtues i AMF-së

## Të tjera

Ndryshime në **Rregulloren nr. 7, datë 30.08.07 "Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare"** - miratuar me Vendim Bordi nr. 38, datë 30.04.2009.

## Objektivat

Gjatë këtij viti janë hartuar dhe miratuar shumë akte ligjore dhe nënligjore, por ka edhe iniciativa të tjera që mbeten për t'u realizuar në vitin e ardhshëm.

Objektivi kryesor është hartimi i ligjit të ri për sigurimin dhe risigurimin. Një asistencë të vlefshme në hartimin e këtij projektligji është duke dhënë Banka Botërore, në kuadër të projektit për një mbikëqyrje efektive, financuar nga FIRST Initiative.

Me realizimin e këtij projektligji do të mbyllet kuadri ligjor i akteve, të cilat rregullojnë veprimtarinë e fushave kryesore të mbikëqyrura nga AMF:

- tregun e sigurimeve dhe operatorët e tij;
- tregun e letrave me vlerë dhe operatorët e tij;
- tregun e fondeve të pensionit privat dhe operatorët e tij;
- veprimtari të tjera financiare jo-bankare.

Tjetër objektiv gjatë vitit 2010 është ndjekja e procesit të hartimit dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të miratuara.

### Akte ligjore të miratuara nga AMF gjatë vitit 2009

**Në fushën e sigurimeve**

1. Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i cili rregullon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe përfshin si të detyrueshme disa produkteve të reja të sigurimit në sektorin e transportit.
2. Rregullore nr. 36, datë 30.04.2009 "Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike", e cila përcakton mënyrën dhe procedurat për raportimin e dëmeve të sigurimeve të detyrueshme përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e qendrës së informacionit të sigurimeve të detyrueshme.

3. Rregullore nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", e cila përcakton rregullat dhe procedurat e trajtimit të dëmeve, që mbulohen nga kontrata e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të avionit, përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit lundrues.
4. Rregullore nr. 67, datë 27.07.2009 "Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit", e cila përcakton kriteret dhe kushtet për dhënien dhe tërheqjen e autorizimit të aktuarit, si dhe përcaktimi i detyrave të tij.
5. Rregullore nr. 75 datë 28.08.2009 "Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", e cila përcakton nivelin e primeve dhe të provigjoneve teknike, përmbajtjen e bazës teknike të të dhënave, metodikat për përllogaritjen e primeve dhe provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Në rregullore përcaktohet gjithashtu procedura dhe afatet për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të tabelave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
6. Rregullore nr. 111, datë 10.12.2009 "Mbi mënyrën e miratimit, financimit dhe administrimit të buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit", e cila përcakton mënyrën e miratimit, financimit dhe administrimit të buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

**Në fushën e letrave e vlerë**

7. Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", i cili ka për qëllim të rregullojë: a) kushtet dhe kriteret për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe të shoqërive administruese; b) emetimin dhe shitjen e kuotave dhe të aksioneve; c) shlyerjen e kuotave; ç) marketimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive; d) veprimtaritë e kryera nga palët e treta, për llogari të sipërmarrjeve të investimeve kolektive; dh) realizimin e mbikëqyrjes nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive administruese, depozitarëve dhe të personave të përfshirë në shitjen e kuotave e të aksioneve, që duhet të mbikëqyren sipas këtij ligji; e) veprimtarinë e sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive dhe të shoqërive administruese të huaja në Republikën e Shqipërisë; ë) funksionimin e drejtë të tregut të kapitaleve dhe nxitjen e lëvizjes së lirë të tyre, nëpërmjet vendosjes së rregullave.
8. Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore", i cili ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore, zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve. Ligji zbatohet për obligacionet: a) e shoqërisë aksionare, me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë; b) e qeverisë vendore. Ky ligj nuk zbatohet në rastet e obligacioneve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë apo të Bankës së Shqipërisë.
9. Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë", e cila përcakton kushtet e kryerjes së transaksioneve që lidhen me kujdestarinë e letrave me vlerë të Qeverisë dhe mënyrës së autorizimit të bankave për kryerjen e kësaj veprimtarie.
10. Rregullore nr. 22, datë 26.03.2009 "Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH", e cila përcakton rregullat për funksionimin dhe mbikëqyrjen e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, ku përfshihen: bono thesari dhe obligacione.
11. Rregullore nr. 41, datë 28.05.2009 "Mbi likuiditetin minimal të shoqërive të brokerimit të letrave me vlerë", e cila përcakton mënyrën e balancimit të aseteve likuide me detyrimet me afat të shkurtër të shoqërisë së brokerimit, si dhe procedurat e raportimit në Autoritet.
12. Rregullore nr. 42, datë 28.05.2009 "Mbi detyrimin e emetuesit për informimin e publikut mbi faktet me rëndësi materiale", e cila ka si qëllim të përcaktojë mënyrën e dhënies dhe të përmbajtjes të informacionit që i duhet dhënë publikut në lidhje me rrethana apo vendime, të cilat përbëjnë fakte me rëndësi materiale, si dhe përcaktimi i rasteve që përbëjnë fakte me rëndësi materiale.
13. Rregullore nr. 68, datë 27.07.2009 "Mbi përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare në fushën e letrave me vlerë", e cila përcakton kërkesat në lidhje me përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare në fushën e letrave me vlerë, si dhe përcaktimin e rrethanave apo marrëdhënieve që krijojnë konflikt interesi.



**14.** Rregullore nr. 74 datë 28.08.2009 "Mbi përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të veprimtarisë tregtare të shoqërive komisionere në letrat me vlerë", e cila përcakton përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të raportimit të veprimtarisë tregtare të shoqërive komisionere në fushën e letrave me vlerë. Me anë të saj sigurohet që Autoriteti dhe përdoruesit e jashtëm të kenë informacion për pozitën financiare, veprimtarinë tregtare dhe ndryshimet e ndodhura në shoqërinë komisionere.

**15.** Ndryshime dhe shtesa në Rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare" - miratuar me Vendim Bordi nr. 76, datë 28.08.2009.

**16.** Ndryshime në Rregulloren nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë" dhe Rregulloren nr. 22, datë 26.03.2009 "Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë" - miratuar me Vendim Bordi nr. 79, datë 28.08.2009.

**17.** Ndryshime në Rregullore nr. 17, datë 21.03.2007 "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare" - miratuar me Vendim Bordi nr. 57, datë 25.06.2009.

**Në fushën e pensioneve private**

**18.** Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar". Qëllimi i këtij ligji është të vendosë standardet e nevojshme për: a) administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit; b) mbikëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit; c) nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit; ç) licencimit dhe mbikëqyrjes së shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të aseteve të fondeve të pensionit dhe të të gjitha çështjeve të lidhura me to.

**Të tjera**

**19.** Ndryshime në Rregullore nr. 7, datë 30.08.07 "Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare" - miratuar me Vendim Bordi nr. 38, datë 30.04.2009.

## 2.2 Aktiviteti licencues

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta në procesin licencues, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e licencimit të zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në tregun financiar jo-bankar, të jenë të qarta, objektive dhe transparente, duke e vënë theksin:

- në gjendjen e shëndoshë financiare të aplikantit;
- në aftësitë profesionale dhe të besueshmërisë të stafit drejtues dhe vendimmarrës të aplikantit;
- në hartimin e strukturave të kënaqshme të mënyrës së qeverisjes së aplikantit, si dhe;
- në paraqitjen e planeve financiare dhe të biznesit në mënyrë sa më të qartë dhe të argumentuar.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në ushtrimin e funksionit licencues, krahas funksionit mbikëqyrës, ka synuar dhe synon drejt një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar, si dhe rritjes së mëtejshme të besimit të publikut ndaj këtij tregu.

## Aktiviteti licencues në tregun e sigurimeve

Gjatë vitit 2009, aktiviteti licencues i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në fushën e tregut të sigurimeve u fokusua në këto drejtime:

- licencim i brokerave dhe shoqërive të brokerimit në sigurime;
- licencim i agjentëve në sigurime;
- licencim i vlerësuesve të dëmeve në sigurime;
- miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit;
- miratime të organeve drejtuese të shoqërive të sigurimit.

### Broker në sigurime

Viti 2009 shënoi licencimin e shoqërive të reja në fushën e brokerimit në sigurime. Licencimi i shoqërisë së parë të brokerimit, në shtator 2008, u pasua nga licencimi i 3 shoqërive të reja në vitin 2009, si:

- Shoqëria "P&C Albania" sh.a, si broker në sigurime për klasat e jo-jetës;
- Shoqëria "DEVON" sh.a si broker në sigurime për klasat e jo-jetës;
- Shoqëria "LANDES Broker" sh.a si broker në sigurime për klasat e jo-jetës.

Në respekt të kërkesës ligjore për ushtrimin e funksioneve të brokerit në emër të shoqërisë së brokerimit nga broker të licencuar, Autoriteti ka kërkuar që çdo shoqëri brokerimi të përfaqësohet në aktivitetin e brokerimit nga brokerat e vet të licencuar. Në funksion të kësaj kërkese, gjatë vitit 2009 janë licencuar 3 brokera fizikë.

### Agjentë në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka kërkuar vazhdimisht nga shoqëritë e sigurimit që shitja e policave të sigurimit në emër të tyre të bëhet nga agjentë të licencuar. Në procesin e licencimit, përveç agjentëve si persona fizikë, janë përfshirë edhe persona juridikë, sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës". Gjatë vitit 2009, Autoriteti miratoi licenca të reja apo rilicencoi agjentë që u kishte përfunduar afati 3-vjeçar i licencës, si më poshtë:

- shoqërinë "UDSA" sh.p.k si agjent në sigurime në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a dhe shoqërisë "Interalbanian" sh.a, dhe 13 përfaqësuesve në rolin e agjentit të licencuar për këtë shoqëri;



- shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a si agjent në sigurime të jo-jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a dhe 23 përfaqësuesve në rolin e agjentit të licencuar për këtë shoqëri;
- 15 agjentë të licencuar (persona fizikë) në emër dhe për llogari të shoqërisë "Insig" sh.a. dhe 2 agjentë të licencuar (persona fizikë) për llogari të shoqërisë "Sicred" sh.a.

### Tabelë 3: Të dhëna mbi agjentë të licencuar

| Emërtimi | Persona Juridikë | Persona Fizikë |
|---|---|---|
| Agjentë të licencuar deri në vitin 2008 | 8 | **114** |
| Të licencuar, apo rilicencuar 2009 | 2 | **53** |
| Tërheqje apo refuzim licence 2009 | - | **2** |
| **GJITHSEJ TË LICENCUAR** | **8** | **161** |

Gjatë kësaj periudhe, Autoriteti tërhoqi 1 (një) licencë për agjentë në sigurime, në emër dhe për llogari të shoqërive të sigurimit, me kërkesë të të licencuarve, si dhe refuzoi përkohësisht dhënien e licencës për 1 (një) aplikant.

## Vlerësuesit e licencuar të dëmeve në sigurime

Vlerësimi i dëmeve nga shoqëritë e sigurimit me vlerësues të licencuar, si proces i filluar në vitin 2008 pas licencimit të 32 vlerësuesve të licencuar, u shoqërua gjatë vitit 2009 me licencimin edhe të 11 vlerësuesve të tjerë, duke e çuar numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime në 43.

Licencat e dhëna në 2009, konsistojnë në vlerësimin e dëmeve materiale dhe shëndetësore për klasat e jo-jetës. Gjithashtu, vlerësuesi i dëmeve në sigurime mund ta ushtrojë profesionin e tij ose i pavarur nga shoqëritë e sigurimit, ose si i punësuar pranë një shoqërie sigurimi. Tabela më poshtë pasqyron të dhënat mbi vlerësuesit e licencuar të ndarë sipas llojit të licencës dhe sipas statusit të tyre.

### Tabelë 4: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar

| Viti | Statusi i vlerësuesit | | Lloji i licencës | | | Gjithsej vlerësues të licencuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | i pavarur | i punësuar | për dëme materiale | për dëme shëndetësore | për dëme materiale dhe shëndetësore | |
| 2008 | 11 | 21 | 1 | 6 | 25 | 32 |
| 2009 | 5 | 6 | - | 1 | 10 | 11 |
| GJITHSEJ | 16 | 27 | 1 | 7 | 35 | 43 |

## Licencat që lëshon autoriteti

- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri sigurimi
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri risigurimi
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë së huaj të sigurimit
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si broker në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri brokerimi në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si vlerësues dëmesh në sigurime
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si Aktuar i Autorizuar
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si konsulent në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri administruese
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si depozitar
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent i fondit të pensionit
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh të fondit të pensionit
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë administruese
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri investimi kolektive me ofertë publike
- Licencë për ushtrim veprimtarie si shoqëri brokerimi në tituj
- Licencë për ushtrim veprimtarie si broker në tituj / komisioner burse
- Licencë për ushtrim veprimtarie si këshilltar investimesh
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si kujdestar i autorizuar
- Licencë për ushtrim veprimtarie si Bursë titujsh
- Licencë për ushtrim veprimtarie si regjistrar

## Testi profesional për profesionet në fushën e sigurimeve

Aktet nënligjore mbi përcaktimin e kritereve të licencimit të profesioneve në fushën e sigurimeve, si profesioni i brokerit në sigurime, profesioni i vlerësuesit të dëmeve, apo profesioni i aktuarit, kanë përcaktuar si kusht licencimi edhe kalimin me sukses të testimit për njohuritë në fushën përkatëse.

Gjatë vitit 2009, Autoriteti ka organizuar rregullisht testime në përputhje me kërkesat e paraqitura nga aplikantë të ndryshëm për t'u pajisur me licenca përkatëse. Qëllimi i organizimit të testeve ka qenë vënia e theksit tek profesionalizmi i aplikantëve që kërkojnë të licencohen, me synimin kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë. Në përbërje të komisioneve të testimit është synuar të jenë përfaqësues me reputacion dhe eksperiencë si nga rrethi akademik, ashtu edhe nga tregu.

Në kuadrin e rritjes së profesionalizmit të profesionistëve që merren me vlerësimin e dëmeve në sigurime, Autoriteti, në maj 2009, miratoi modulet bazë që duhet të përmbajë programi i trajnimit të këtij profesioni. U gjykua që programi i trajnimit duhet të kombinojë njohuritë në fushën e sigurimeve në lidhje me vlerësimin e dëmeve, me njohjen e etikës profesionale dhe të legjislacionit.

## Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Miratimet e dhëna nga Autoriteti gjatë vitit 2009 në lidhje me ndryshimet statutore kanë konsistuar:

- në ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të madhësisë së kapitalit aksionar për 4 shoqëri sigurimi;



- në ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare për 2 shoqëri sigurimi;
- në ndryshimin e statutit si rrjedhojë e pasqyrimit të kërkesave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 " Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare", për 2 shoqëri sigurimi;
- në ndryshimin e statutit si pasojë e ndryshimit të emrit të shoqërisë (nga "Sigma" sh.a në "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a).

| *Arsyeja e ndryshimit të statutit* | *Numri i shoqërive* 2008 | 2009 |
|---|---|---|
| Statut i ri / ndryshime në statut | 2 | 2 |
| Rritje kapitali | 9 | 4 |
| Ndryshim i strukturës aksionare | 2 | 2 |
| Ndryshim i përbërjes së këshillit mbikëqyrës | 2 | 4 |
| Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë | 2 | 1 |

## Rritja e prezencës së kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit

Në prill 2009, Autoriteti miratoi pjesëmarrjen kontrolluese të aksionarit "Vienna Insurance Group" në masën 87% +1 në shoqërinë e sigurimit "Sigma" sh.a, si rezultat i blerjes së aksioneve nga shoqëria "TBIH Financial Services Group N.V Amsterdam". Vienna Insurance Group është shoqëri e përbërë sigurimesh që ofron sigurime jete dhe jo-jete, me aktivitet në mbi 23 shtete, veçanërisht në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Në nëntor 2009, Autoriteti miratoi pjesëmarrjen kontrolluese të shoqërisë UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH në shoqërinë "Sigal Holding" sh.a (zotëruese e kapitalit të shoqërisë Sigal dhe Sigal-Life) në masën 68.65%.

## Qeverisja e shoqërive të sigurimit

Edhe për vitin 2009, struktura e qeverisjes së shoqërive të sigurimit nuk pati ndryshime, ajo paraqitet si skema në krah.
Në rritjen e rolit mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit, AMF ka respektuar kriteret për

**Struktura aktuale**



të zgjedhurit në këshillat mbikëqyrës, në postet drejtuese apo komitetet e kontrollit. Në të njëjtën kohë, AMF ka tentuar të nxisë rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit, brenda kuadrit ekzistues rregullativ. Gjatë vitit 2009, Autoriteti ka miratuar ndryshime në anëtarët e këshillave mbikëqyrës në katër shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar rimandatimin e drejtorit të përgjithshëm në një shoqëri sigurimi.

| Qeverisja e shoqërive të sigurimit - statistika | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|---|---|---|
| ▪ Numri mesatar i aksionarëve | 6 | 4.5 | 4.2 |
| ▪ Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës | 5 | 3.6 | 3.4 |
| ▪ Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë | 2 | 2.8 | 2.7 |
| ▪ Numri i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10% | 3 | 3 | 2 |

### Numri i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese




### Tabelë 5: Të dhëna për aksionarët - 2009

| Emërtimi | Numri |
|---|---|
| Shoqëri sigurimi | 10 |
| Aksionarë gjithsej | 42 |
| Me pjesëmarrje zotëruese si më poshtë: | |
| *nën 10%* | *26* |
| *mbi 10% nën 20%* | *3* |
| *mbi 20% nën 33 %* | *3* |
| *mbi 33% nën 50%* | *1* |
| *mbi 50%* | *9* |
| Aksionarë të huaj | 4 |
| Aksionarë vendas | 38 |
| Aksionarë si individë | 34 |
| Aksionarë si shoqëri | 7 |
| Aksionarë shteti | 1 |



## Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", Autoriteti mori në shqyrtim masat e marra nga shoqëritë e licencuara më parë (për ushtrim veprimtarie tregtimi sipas Ligjit nr. 8080, datë 03.05.1996 "Për letrat me vlere" - i shfuqizuar) për riorganizimin e veprimtarisë së tyre në tituj (letrat me vlerë) sipas kërkesave të ligjit të ri dhe miratoi rilicencimin e 8 bankave, 2 shoqërive të brokerimit dhe të Postës Shqiptare si broker në tregun me pakicë. Ndërkohë, Autoriteti miratoi heqjen e licencës për një shoqëri brokerimi në letrat me vlerë për shkak të mos përshtatjes me kërkesat e ligjit të ri "Për titujt".

Gjithashtu, për të gjitha subjektet që operojnë në tregun e letrave me vlerë, Autoriteti miratoi formatin e ri të licencave, në përputhje me kërkesat dhe terminologjinë e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt".

Gjatë vitit 2009, Autoriteti miratoi dhënien e licencës për 6 brokera në letrat me vlerë, si përfaqësues të bankave të licencuara për të ushtruar veprimtari brokerimi dhe 1 brokeri, përfaqësues i shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a.

### Tabelë 6: Shoqëritë e licencuara për të operuar në tregun e letrave me vlerë

| Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë | Nr. dhe data e licencës | Objekti i veprimtarisë | Numri i brokerave fizikë |
|---|---|---|---|
| Tirana Bank | Nr. 1, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh (bono thesari) në Bursë | 1 |
| Triumf Grup | Nr. 2, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh (bono thesari) në Bursë | 1 |
| Raiffeisen Bank | Nr. 3, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë dhe në tregun me pakicë të tyre | 1 |
| Banka Popullore | Nr. 4, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh (bono thesari) në Bursë | 1 |
| Alpha Bank | Nr. 5, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë dhe në tregun me pakicë të tyre | 2 |
| Banka Credins | Nr. 6, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë dhe në tregun me pakicë të tyre | 1 |
| Kapital Invest | Nr. 7, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë dhe në tregun me pakicë të tyre | 1 |
| Banka Kombëtare Tregtare | Nr. 8, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë dhe në tregun me pakicë të tyre | 3 |
| Posta Shqiptare | Nr. 9, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh (bono thesari) në tregun me pakicë të tyre | 1 |
| Intesa Sanpaolo Bank | Nr. 10, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë dhe në tregun me pakicë të tyre | 1 |
| Banka Ndërkombëtare Tregtare | Nr. 11, datë 25.06.2009 | Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së R.Sh në Bursë | 1 |

### Subjektet që përgatitin dhe publikojnë analiza financiare

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", subjektet që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre profesionale apo tregtare përgatitin dhe publikojnë analiza financiare, duhet të njoftojnë Autoritetin.

Gjatë vitit 2009, Autoriteti, duke gjykuar mbi informacionet dhe analizat e publikuara nga shoqëria "Green Market" sh.p.k mbi çmimet e produkteve bujqësore, përfshirë edhe informacion mbi kontratat "forward" të këtyre produkteve, miratoi njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë "Green Market" sh.p.k si subjekt që publikon informacione dhe analiza në letrat me vlerë që lidhen me sektorin e bujqësisë.

**Miratime të tjera në tregun e letrave me vlerë**

- Ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë "Qendra e Regjistrit të Aksioneve" sh.a - prill 2009
- Ndryshim në statutin e shoqërisë "Triumf-Group" sh.a në lidhje me zmadhimin e kapitalit aksionar - qershor 2009

## Aktiviteti licencues në tregun e pensioneve private

Edhe gjatë vitit 2009, veprimtaria e administrimit të pensioneve private suplementare u kufizua tek 3 shoqëritë e licencuara më parë si Institute Private të Pensioneve Suplementare.

Hyrja në fuqi e Ligjit të ri nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" do t'i japë frymëmarrje tregut të pensioneve private. Institutet ekzistuese të pensioneve, të krijuara në përputhje me Ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", duhet të paraqesin, sipas dispozitave të ligjit të ri, kërkesën për licencë brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Brenda kësaj periudhe, institutet private të pensioneve do të vazhdojnë funksionimin, sipas kushteve që kanë qenë të vlefshme në çastin e krijimit të tyre.

Gjatë vitit 2009, Autoriteti miratoi disa ndryshime në lidhje me bordet drejtuese, me synim përmirësimin e nivelit të menaxhimit të Instituteve Private te Pensioneve, si dhe miratime në lidhje me ndryshimin e madhësisë së kapitalit.

Kështu:

- Në prill 2009 miratohet Bordi Drejtues i shoqërisë **"Instituti privat i pensioneve suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pension" sh.a**.
- Në korrik 2009 miratohet një ndryshim në Bordin Drejtues të shoqërisë **"Sigma IPP" sh.a**.
- Në maj 2009 miratohet ndryshimi i statutit të shoqërisë **"Capital IPP" sh.a**, si rezultat i zmadhimit të kapitalit.



## 2.3 Aktiviteti mbikëqyrës

Viti 2009 shënoi vitin e parë të raportimit të pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF dhe SNK) në përmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004".

### Mbikëqyrja efektive e sigurimeve

Gjatë vitit 2009 ka vazhduar puna për realizimin e projektit "Për Mbikëqyrjen Efektive", i cili ka filluar në vitin 2008 me asistencën e Bankës Botërore dhe financim të FIRST Initiative. Puna e stafit mbikëqyrës është përqëndruar në drejtim të hartimit të manualit të integruar të inspektimit, i cili do ta ndihmojë atë  në zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes, atë me bazë riskun. Për hartimin e këtij manuali, përveç ekspertizës nga ekspertë të Bankës Botërore, janë shfrytëzuar dhe modele të vendeve, të cilat aktualisht zbatojnë këtë metodologji të re mbikëqyrjeje, duke punuar për adaptimin e kësaj metodologjie në kushtet e tregut shqiptar të sigurimeve.
Koncepti bazë i përqasjes bazuar në risk është të indentifikojë zonat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe kur është e nevojshme, të punojë me menaxhimin e tij në mënyrë që ta ulë riskun në nivele të pranueshme. Objektivi është që problemet financiare të parandalohen përpara se të ndodhin, në vend që të punohet për zgjidhjen e tyre pasi ato të kenë ndodhur.
Disa nga avantazhet e metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë risku krahasuar me metodologjinë tradicionale bazuar në rregulla, përmblidhen si më poshtë:

- **Përfitimet krahasuese**, pasi shumë nga rregullat vlejnë për situata që nuk janë më të rëndësishme, ndërkohë që aty ku ka realisht probleme, ato nuk mund të trajtohen me kuadrin ligjor aktual;
- **Shmangia e problemit**, duke njohur riskun dhe duke u përpjekur të zbatohen masa për reduktimin dhe kontrollin e tij, para se situata të bëhet kritike;
- **E ndjeshme ndaj burimeve**, për t'i fokusuar ato në situatat që kanë risk më të madh dhe mundësi më të madhe për dëmtime të sistemit financiar;
- **E strukturuar dhe e qëndrueshme**, në vlerësimin e riskut dhe në vendimmarrje përmes përdorimit të variablave të pranuar për matjen e tij;
- **Transparente - për siguruesit**, të cilëve duke ju dhënë informacion se si matet risku, fillojnë të mendojnë për alternativa risku më të vogla për arritjen e objektivave të tyre të dëshiruara;
- **Studion të gjitha risqet e konsiderueshme të biznesit dhe menaxhimin e tyre,** duke bërë një analizë sasiore dhe cilësore të risqeve të evidentuara dhe duke u fokusuar në ato zona që paraqesin risk më të lartë;
- Mundësi për të **parë dinamikën e ndryshimit të profilit të riskut, si** për kompaninë e sigurimit edhe për tregun e sigurimeve.

Zbatimi i këtyre standardeve siguron një informacion të besueshëm dhe të krahasueshëm për investitorët dhe klientët nëpërmjet transparencës më të lartë të raportimit.
Meqenëse standardi SNRF 4, i cili lidhet me kontratat e sigurimit dhe risigurimit, nuk ka marrë ende formë të plotë, është i pashmangshëm fakti që procesi i zbatimit të plotë të SNRF-ve në tregun e sigurimeve kërkon fazën e vet të tranzicionit.

AMF e kryen funksionin e saj të mbikëqyrjes së tregjeve përmes analizimit të dokumentave (kontrolli dokumentar "off-site") të raportuara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe ndërmarrjes së inspektimeve në vend tek subjektet e mbikëqyrura (inspektimi në vend "on-site").

**Inspektimi dokumentar (off-site)** kryesisht bazohet në analizimin e pasqyrave periodike, teknike e financiare, të depozituara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe çfarëdo dokumentacioni të kërkuar me ligj. Nëse nga analizimi i pasqyrave vihen re parregullsi apo mangësi, AMF reagon përkatësisht për eliminimin e shkeljeve.

**Inspektimi në vend (on-site)** mund të jetë i planifikuar më parë (me paralajmërim) apo ad-hoc, në rastet kur mund të jetë i lidhur me sinjalet e ndryshme apo ankesat e konsumatorëve, në lidhje me aktivitetin e subjekteve të mbikëqyrura.

Objektivi kyç i inspektimit në vend është që inspektorët të sigurohen, që subjekti që po inspektohet, po menaxhohet dhe kontrollohet në përputhje me praktika të shëndosha financiare të biznesit.

**Objektivat kryesore të inspektimit on-site**

1. Njohja e ambientit dhe strategjisë së biznesit të siguruesit duke përcaktuar risqet e tij.
2. Evidentimi i zonave me risk të lartë.
3. Parandalimi i problemeve financiare përpara se ato të ndodhin.
4. Evidentimi i siguruesve me probleme potenciale financiare lidhur me aftësinë paguese.
5. Identifikimi i mospërputhjeve me legjislacionin në fuqi.
6. Komunikimi i gjetjeve dhe rekomandimeve përkatëse, subjektit të mbikëqyrur.
7. Marrja e masave në kohë të përshtatshme për korrigjime të mundshme.

Kontrolli në vend dhe ai dokumentar mund të përfshijnë një tematikë të gjerë, ose mund të fokusohen në çështje të veçanta, të cilat i nënshtrohen inspektimit në vend tematik, ose me objekt të kufizuar.

## Analiza Financiare e Tregut të Sigurimeve (off-site)

Gjatë vitit 2009, Autoriteti ka analizuar dhe monitoruar situatën financiare të tregut të sigurimeve dhe në veçanti të shoqërive të sigurimit, duke pasur si prioritet gjatë ushtrimit të funksioneve të tij përmirësimin e proçesit të mbikëqyrjes së këtij tregu.

Autoriteti, në kuadrin e funksionit të mbikëqyrjes e veçanërisht në kushtet e krizës globale të tregjeve financiare, ka ndjekur me prioritet një strategji të kujdesshme për monitorimin, parandalimin dhe reagimin ndaj efekteve të mundshme të kësaj krize në tregun financiar shqiptar. Kjo strategji, gjatë vitit 2009, ka konsistuar në:

- dhënien e rekomandimeve konkrete për rritjen e disiplinës së tregut dhe ndërmarrjen e masave mbrojtëse ndaj risqeve me ekspozim më të lartë;



- forcimin e mbikëqyrjes së treguesve teknikë të kapitalit, likuiditetit dhe menaxhimit të riskut të institucioneve të licencuara;
- takime në kuadër të Grupit të Stabilitetit Financiar, pjesëmarrës të të cilit janë AMF, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, për të marrë në konsideratë situatën dhe koordinimin e aktiviteteve;
- ndjekjen e grupeve ose shoqërive të huaja, të cilat kanë investuar në kapitalin e shoqërive shqiptare të sigurimeve.

Struktura e tregut të sigurimeve, edhe gjatë vitit 2009, vazhdon të përbëhet nga dhjetë shoqëri sigurimesh, nga të cilat shtatë ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës, dy në sigurimet e Jetës dhe një në sigurimet e Jo-Jetës dhe Jetës së bashku.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në "depozita qëllimore" me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit.

### Tabelë 7: Bilanci kontabël i tregut të sigurimeve

*(në mln lekë)*

| *Bilanci Kontabël i Tregut të Sigurimeve* | *31.12.2007* | *% ndaj totalit* | *31.12.2008* | *% ndaj totalit* | *31.12.2009* | *% ndaj totalit* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Depozita | 6,104 | 46% | 7,601 | 49% | 8,091 | 50% |
| Toka dhe ndërtime | 1,001 | 7% | 1,620 | 11% | 1,584 | 10% |
| Aksione dhe pjesëmarrje | 1,108 | 8% | 1,339 | 9% | 1,339 | 8% |
| Bono Thesari | 1,330 | 10% | 624 | 4% | 488 | 3% |
| Debitorë | 1,137 | 9% | 1,168 | 7% | 1,365 | 8% |
| Aktive të tjera | 2,678 | 20% | 3,175 | 20% | 3,358 | 21% |
| TOTALI I AKTIVIT | 13,358 | 100% | 15,526 | 100% | 16,227 | 100% |
| Provigjonet teknike bruto | 5,928 | 44% | 5,139 | 33% | 6,229 | 38% |
| Detyrime të tjera | 474 | 4% | 1,554 | 10% | 1,451 | 9% |
| Kapitalet e veta | 6,956 | 52% | 8,833 | 57% | 8,545 | 53% |
| TOTALI PASIVIT | 13,358 | 100% | 15,526 | 100% | 16,227 | 100% |

Sipas raportimit financiar të shoqërive të sigurimit, për vitin 2009, u vu re se:

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve arriti në vlerën 16.2 mld lekë, nga 15.5 mld lekë që ishte në 31.12.2008, duke shënuar një rritje në masën 4.5%.

Depozitat me afat ne banka arritën në vlerën 8,091 mln lekë në 31.12.2009, duke shënuar një rritje prej 490 mln lekë në krahasim me 31.12.2008 dhe duke përbërë zërin më të lartë të aktiveve të tregut në masën 50% të totalit të aktiveve. Bonot e Thesarit përbëjnë rreth 3% të totalit të aktiveve të tregut, duke e rritur kështu në 52.7% pjesën e aktiveve likuide.

**Tabelë 8: Disa karakteristika mbi tregun e sigurimeve**

*(në mln lekë)*

| *Periudha Ushtrimore* | *2005* | *2006* | *2007* | *2008* | *2009* |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i aktiveve** | **10,216** | **11,453** | **13,360** | **15,525** | **16,227** |
| Jeta | 1,140 | 1,171 | 1,401 | 1,841 | 2,919 |
| Jo-Jeta | 9,076 | 10,282 | 11,959 | 13,684 | 13,308 |
| **Totali i investimeve** | **6,946** | **8,014** | **9,255** | **11,182** | **10,830** |
| Jeta | 898 | 973 | 1,071 | 1,389 | 2,101 |
| Jo-Jeta | 6,049 | 7,041 | 8,184 | 9,793 | 8,729 |
| **Provigjonet teknike bruto** | **4,917** | **5,518** | **5,929** | **5,138** | **6,229** |
| Jeta | 131 | 218 | 227 | 233 | 361 |
| Jo-Jeta | 4,786 | 5,300 | 5,702 | 4,905 | 5,868 |
| **Totali i kapitalit** | **4,689** | **5,557** | **6,956** | **8,832** | **8,546** |
| Jeta | 942 | 926 | 1,247 | 1,541 | 1,754 |
| Jo-Jeta | 3,747 | 4,632 | 5,709 | 7,291 | 6,792 |
| **Totali i kapitalit të nënshkruar** | **3,396** | **3,788** | **5,191** | **6,031** | **5,787** |
| Jeta | 868 | 868 | 1,001 | 1,248 | 1,097 |
| Jo-Jeta | 2,528 | 2,920 | 4,190 | 4,783 | 4,690 |
| **Totali i investimeve të huaja** | **1,068** | **1,149** | **2,378** | **2,924** | **1,985** |
| Jeta | 224 | 215 | 379 | 460 | 355 |
| Jo-Jeta | 844 | 933 | 1,999 | 2,463 | 1,630 |
| **Primet e shkruara bruto** | **4,011** | **4,542** | **5,948** | **7,076** | **7,877** |
| Jeta | 239 | 302 | 410 | 515 | 721 |
| Jo-Jeta | 3,772 | 4,239 | 5,538 | 6,561 | 7,156 |
| **Primi i fituar neto** | **3,730** | **3,910** | **4,705** | **5,543** | **6,092** |
| Jeta | 201 | 241 | 357 | 459 | 469 |
| Jo-Jeta | 3,529 | 3,669 | 4,348 | 5,083 | 5,596 |
| **Dëmet e paguara bruto** | **1,226** | **1,287** | **1,294** | **1,571** | **1,733** |
| Jeta | 15 | 12 | 44 | 45 | 79 |
| Jo-Jeta | 1,211 | 1,275 | 1,250 | 1,526 | 1,654 |

Autoriteti ka verifikuar në fund të çdo tremujori nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, aftësinë aktuale paguese (kapitalin) dhe investimin e tij. Aftësia aktuale paguese e tregut më 31.12.2009 është në vlerën 4,999 mln lekë.

## Treguesit Financiarë IRIS

Në kuadrin e punës së Autoritetit për ngritjen e një tregu financiar të stabilizuar dhe në kuadrin e projektit të Autoritetit në bashkëpunim me Bankën Botërore, me synim kalimin në drejtim të metodës të mbikëqyrjes me bazë risku, gjatë vitit 2009, ka vazhduar të zbatohet sistemi i paralajmërimit të hershëm.



Kështu, në analizën e gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve, në vlerësimin e shoqërive, përdoren edhe treguesit e sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në Shqipëri.

Këto tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg.

**Tabelë 9: Diapazonet e vlerave të indikatorëve financiarë IRIS**

| | | | | Kufiri (%) | |
|---|---|---|---|---|---|
| *Raporti* | *31.12.2007* | *31.12.2008* | *31.12.2009* | *MIN* | *MAX* |
| Norma e rritjes së primit | 30.97% | 19.31% | 11.32% | -40 | 40 |
| Raporti i mbajtjes neto | 86.16% | 80.38% | 83.22% | 40 | 80 |
| Raporti dëme/prime neto | 24.19% | 25.78% | 34.47% | 50 | 80 |
| Raporti i shpenzimeve | 55.62% | 64.84% | 69.45% | 25 | 50 |
| Raporti i kombinuar | 79.81% | 90.62% | 103.92% | 85 | 105 |
| Te ardhurat nga investimet | 4.55% | 6.69% | 7.99% | 4 | 8 |
| Raporti i kapitalit | 74.84% | 75.28% | 63.47% | 20 | 50 |
| Raporti i provigjoneve teknike | 94.39% | 89.95% | 91.94% | 10 | 30 |
| Raporti i aftësisë paguese | 539.19% | 424.48% | 374.4% | 150 | 300 |

Norma e rritjes së primeve të tregut të sigurimeve është brenda kufijve të përcaktuar. Kështu më 31.12.2009, norma e rritjes së primeve të tregut është 11.32%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Raporti i mbajtjes neto në tregun shqiptar të sigurimeve është në masën 83.22% për vitin 2009. Normat e përcaktuara ndërkombëtare rekomandojnë vlera midis 40-80%.

Raporti dëme/prime në nivel tregu është në masën 34.47%, dhe ndonëse ka pësuar rritje me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar vijon të mbetet në nivele të ulta.

Raporti i shpenzimeve, vazhdon të jetë në përmasa jo normale për një shoqëri sigurimi, por ky përbën një fenomen për të gjithë tregun e sigurimeve. Në 31.12.2009, ky raport është në masën 69.45% për tregun e sigurimeve. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 67% për tregun e Jo-Jetës.
Raportet financiare të ilustruara më poshtë janë për të gjitha shoqëritë e sigurimit.

## Treguesit IRIS 2009




## Inspektime në vend (on-site) në subjektet e mbikëqyrura

Inspektimi në vend është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes. Ky proces nuk mund të quhet i realizuar si cikël, pa kryerjen e inspektimit në vend. Cikli i mbikëqyrjes kryhet brenda kuadrit ligjor dhe në përputhje me politikat dhe procedurat e hartuara nga AMF.



Monitorimi dhe analizimi i të dhënave financiare dhe statistikore të raportuara nga operatorët e tregut, raporteve të auditorëve dhe aktuarëve, informacioneve të tjera nga tregu, ndihmojnë në planifikimin e inspektimeve në vend tek subjektet e mbikëqyrura për të evidentuar risqet e këtyre subjekteve dhe për të punuar për mbajtjen e tyre brenda kufijve të pranueshëm.

Gjatë vitit 2009 janë kryer 14 inspektime në vend në subjektet e mbikëqyrura, nga të cilat 10 inspektime të plota dhe të planifikuara, 2 inspektime tematike dhe 2 inspektime të përbashkëta.

## Inspektime në subjektet e mbikëqyrura

### Inspektimi i pasqyrave financiare

Shoqëritë e sigurimit kanë raportuar për herë të parë në Autoritet, Pasqyrat Financiare për periudhën 31.12.2008, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit, ka ushtruar inspektime në 10 shoqëritë e sigurimit (Jetë dhe Jo-Jetë) me qëllim:

- verifikimin e aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të shoqërive të sigurimit për vitin 2008 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2009;
- verifikimin e drejtimeve të investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike sipas kategorive dhe limiteve të lejueshme të investimit, të përcaktuara në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe aktet nënligjore;
- vlerësimin e cilësisë së aktiveve dhe nivelin e likuiditetit të tyre;
- shqyrtimin e politikave kontabël në lidhje me njohjen, matjen fillestare dhe të mëvonshme të kategorisë së investimeve sipas SNRF-ve, veprimet e procesit të rivlerësimit të aseteve (në ato raste që ka pasur);

**Hapat e procesit të inspektimit**

- Përcaktimi i qëllimit dhe formës së inspektimit
- Grumbullimi dhe shqyrtimi i të dhënave
- Hartimi i programit të inspektimit
- Emërimi i personelit inspektues
- Prezantimi i programit të inspektimit me drejtuesit e subjektit
- Kryerja e inspektimit
- Hartimi i projekt raportit të inspektimit
- Dërgimi i projekt raportit tek subjekti i inspektuar dhe marrja e opinionit
- Përgatitja e raportit përfundimtar

- verifikimin e përgjegjësive të kontraktuara dhe risigurimeve të kryera sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, si dhe akteve përkatëse nënligjore.

Pjesë e këtij inspektimi ka qenë edhe verifikimi në vend i procedurave të ndjekura nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në procesin e pranimit, trajtimit, vlerësimit dhe pagesës së dëmeve duke evidentuar afatet dhe procedurat e tyre, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 "Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta".

Konkluzionet dhe rekomandimet që rezultuan nga inspektimet e kryera shërbyen si bazë për analizën e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit për vitin 2008 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2009.

### Inspektime të tjera në vend

Këto inspektime konsistuan në verifikimin në vend të fakteve të konstatuara gjatë raportimit periodik në Autoritet, kryesisht në lidhje me shitjet online të policave të sigurimit dhe problematikës së dalë gjatë analizës financiare vjetore të shoqërive të sigurimit.

Në vitin 2009, janë kryer 2 inspektime tematike në pikat e shitjes pranë qendrës së kontrollit teknik të automjeteve, me qëllim mbikëqyrjen e aspekteve të veçanta të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe agjentëve në sigurime, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës së sigurimeve dhe në zbatim të Rregullores "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik", miratuar me Vendimin e Bordit të AMF, nr. 3, datë 03.10.2007.

Këto inspektime u përqendruan në verifikimin nëse:

- agjentët në sigurime raportojnë shitjen e çdo police sigurimi të detyrueshëm motorik, vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik të sigurimeve të detyrueshme motorike, të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- agjentët në sigurime kanë furnizuar këtë bazë të dhënash në kohë reale online për çdo shitje policash sigurimi të detyrueshëm motorik;
- numri unik i raportimit në momentin e lëshimit nga rrjeti i shitjes, raportohet në bazën e të dhënave qendrore në regjistrin elektronik online të sigurimeve të detyrueshme motorike në Autoritet.



## Inspektime të përbashkëta

Në shtator 2009, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis dy rregullatorëve financiarë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), u organizua nga Drejtorati i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve të BQK një inspektim i përbashkët në një nga shoqëritë shqiptare të sigurimit të Jo-Jetës, që ka shtrirë aktivitetin e saj edhe në Kosovë.

Objekti i këtij inspektimi në vend ishin:

- sistemet e informacionit dhe verifikimi i tyre, procedurat e marrjes në sigurim, procesimi i kërkesave për zhdëmtim, rezervat teknike, kontratat e risigurimit, drejtimet e investimit, sistemet informative të menaxhimit të lartë, qeverisja e përbashkët dhe menaxhimi i lartë;
- raporti i auditorit të pavarur, si dhe;
- korrektësia ndaj policëmbajtësve.

AMF, në vazhdimësi gjatë vitit 2009, në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë ka kryer inspektim të përbashkët tematik në bankat e nivelit të dytë për verifikimin e:

- depozitave të kompanive të sigurimit;
- llogarive rrjedhëse të tyre;
- kredive të marra nga shoqëritë e sigurimit, kontratat e sigurimit të kredive; si edhe kolateralet e garantuara prej tyre.

Mbështetur në gjetjet, problematikën apo mangësitë e konstatuara nga këto inspektime, Bordi i AMF-së, mori vendime që kishin të bënin me marrjen e masave apo vendosjen e sanksioneve ndaj shoqërive të sigurimit, si dhe me dhënien e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit.

### Hapësirë Informimi

Masat administrative që parashikon Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime":

- Urdhër për eliminim shkeljesh
- Masa korigjuese
- Plan financiar
- Gjobë subjektit
- Gjobë personit përgjegjës
- Pezullim personit përgjegjës
- Tërheqje licence (tërësore ose pjesore)
- Administrim i përkohshëm
- Likuidim

Masat administrative që parashikon Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit":

- Sanksione ndaj shoqërive të sigurimit, personave përgjegjës të shoqërive të sigurimit, drejtorit ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS), personave përgjegjës të BSHS
- Masa administrative të qarta në lidhje me procedurat dhe afatet për rregullimin e shpërblimit të dëmit (neni 12)

Për shkelje të këtij neni për shoqëritë e sigurimit parashikohen:

- shpallje publikisht, me shpenzimet e veta e të dhënave për praktika të gabuara
- tërheqje e miratimit për anëtarët e organeve drejtuese
- tërheqje, përkohësisht ose përfundimisht e licencës për kryerjen e veprimtarisë përkatëse

Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" parashikon sanksione administrative, për çdo person, ortak apo aksionar të personit juridik, që pengon Autoritetin, strukturat apo nëpunësit e tij për ushtrimin e kompetencave të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

## Masat korigjuese dhe administrative

Ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është ruajtja e qëndrueshmërisë së tregut financiar jo-bankar.

Veprimet e Autoritetit në këtë drejtim përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato zona të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit 2009, në disa raste ka qenë e nevojshme ndërhyrja e Autoritetit nëpërmjet masave administrative, me qëllim eliminimin e shkeljeve, duke siguruar kthimin në gjendje të shëndoshë të subjekteve të mbikëqyrura në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti në veprimet e tij udhëhiqet nga transparenca dhe trajtimi i barabartë i subjekteve financiare jo-bankare në lidhje me marrjen e masave korigjuese dhe administrative.

Vendosja e masave ndaj subjekteve të mbikëqyrura ka ndikuar në përmirësimin e pozitave financiare të disa subjekteve, si dhe ka ndikuar në eliminimin e shkeljeve.

### Masat administrative të ndërmarra gjatë vitit 2009

Gjatë vitit 2009, përveç procedurës kryesore të mbikëqyrjes së Autoritetit, nëpërmjet inspektimeve apo analizave financiare, tematika e inspektimeve është identifikuar edhe nga një sërë burimesh të tjera, duke përfshirë këtu edhe ankesat.

### Për shoqëritë e sigurimit

Autoriteti, bazuar në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", ka ndërmarrë disa masa administrative duke zbatuar parimin e gradualizmit, i cili shtrihet duke filluar që nga masat korigjuese, masat administrative ndaj personave përgjegjës, deri në sanksion me gjobë, si mjetin më të fundit për të detyruar subjektet e mbikëqyrura për të eliminuar shkeljet.

Problematikat dhe shkeljet e hasura kanë të bëjnë me: qëndrueshmërinë financiare të shoqërive të sigurimit, raportimin e saktë, rregullat e menaxhimit të rrezikut, ushtrim veprimtarie sipas klasave të licencuara, shitjen e produktit të sigurimit të detyrueshëm në përputhje me legjislacionin përkatës.

### Për institutet private të pensioneve

Autoriteti i kufizuar nga legjislacioni në fuqi i veprimtarisë së instituteve private të pensioneve, Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për Pensionet Suplementare dhe institutet



private të Pensioneve" (i ndryshuar), me qëllim stabilitetin financiar të këtyre subjekteve dhe mbrojtjen e interesave të aderuesve, ka pasur në vëmendje të veçantë ecurinë e instituteve private të pensioneve, kryesisht në drejtim të plotësimit të fondit të garancisë.

Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur zbatimin e masave korigjuese, nëpërmjet raporteve të depozituara nga subjektet e mbikëqyrura sipas afateve të përcaktuar në vendimet e Bordit.

Sipas frekuencës së problematikave dhe nivelit të rrezikut që paraqet, Autoriteti ka urdhëruar subjektet e mbikëqyrura të paraqesin raporte të plota për eliminimin e shkeljeve ku dëshmojnë se shkeljet e përcaktuara janë eliminuar.

Me qëllim monitorimin e praktikave të gabuara, Autoriteti ka kryer takime të rregullta për dorëzimin në kohë të informacionit për çështje të ndjeshme, të cilat kërkojnë veprim të menjëhershëm. Gjithashtu, në këtë drejtim është rritur ndjeshëm marrja e vazhdueshme e informacionit.

**Tabelë 10: Masa administrative të marra nga AMF ndaj subjekteve të mbikëqyrura**

| *Subjekti i mbikëqyrur* | *Lloji i masës* | *Numri* |
|---|---|---|
| **Shoqëri sigurimi** | - *Masa korrigjuese* | *11* |
| | - *Urdhër për raportim* | *6* |
| | - *Kufizim shpërndarje fitimi* | *1* |
| | - *Sanksion me gjobë* | *4* |
| **Person përgjegjës pranë shoqërisë së sigurimit** | - *Sanksion me gjobë* | *1* |
| **Institut privat pensionesh** | - *Masa korrigjuese* | *2* |
| **Aplikant për ndërmjetës në sigurime** | - *Refuzim licence (Agjent)* | *1* |
| | - *Refuzim licence (Broker)* | *1* |

## 2.4 Teknologjia e informacionit

Teknologjia e Informacionit (TI) në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është në zhvillim të vazhdueshëm si pjesë e pandarë e Institucionit, duke pasur si objekt pune dhe strategji zhvillimi mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike të brendshme dhe të shërbimeve, si dhe projektimin e ndërtimin e sistemeve informatike në shërbim të Autoritetit dhe subjekteve në mbrojtje e mbikëqyrje. Viti 2009 është karakterizuar nga një zhvillim cilësor në projektimin, ndërtimin dhe administrimin e sistemeve informatike në mbështetje të strategjisë së Autoritetit.

Gjatë vitit 2009 janë zhvilluar aktivitete, me qëllim përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij, mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe aktivitete për projektimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike të brendshme të Autoritetit. Në kuadër të përmirësimit të aktivitetit të brendshëm, TI siguron administrimin e vazhdueshëm në nivel aplikimi, bazën e të dhënave, menaxhimin e sigurisë dhe ndihmën e vazhdueshme teknologjike për punonjësit e institucionit.

## Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Ndër projektet më të rëndësishëm të tre vjeçarit 2007-2009 në projektim, ndërtim, koordinim e administrim, është Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, ku është realizuar me sukses faza e parë, Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike.



Seminar mbi prezantimin e sistemit të ri të raportimit elektronik të Mbikëqyrjes AMF In-Reg

Gjatë vitit 2009 është realizuar me sukses të plotë dhe vënë në përdorim faza e dytë e projektit: Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike. Për të mundësuar fazën e tretë të projektit, krijimin e sistemit Bonus-Malus, Regjistri i Dëmeve është plotësuar me të dhënat historike të dëmeve për tre vitet e fundit. Sistemi është ndërtuar në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit dhe përpunon tërësinë e informacionit të nevojitur si pjesë e aktivitetit të institucionit, ndërkohë që garanton stabilitet, siguri dhe vazhdueshmëri të proceseve të punës të pjesëmarrësve të tregut.

**Faza I: Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike**
Regjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorike përbëhet nga platforma e raportimit dhe identifikimit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar. Regjistri është në përdorim nga data 1 dhjetor 2007 dhe në mirëmbajtje e ndryshime të suksesshme pranë AMF gjatë vitit 2009. Në regjistrin e sigurimeve regjistrohen detaje të policave të sigurimeve të detyrueshme motorike të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit. Pjesë e procesit është dhe lëshimi i një numri unik në kohë reale nga serveri qendror, i cili realizon identifikimin e policave, duke mundësuar kështu dhe shmangien e abuzimeve me natyrë falsifikuese ose mos raportimit të policave.

Përveç aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të suportit të vazhdueshem teknik, përmirësimit të testimit, kontrollit automatik të shërbimeve dhe aksesit në sistem nga ana e shoqërive të



sigurimit, projektimit dhe zbatimit në sistem të ndryshimeve të kërkuara nga Ministria e Financave gjatë vitit 2009 dhe automatizimit të raportimit ditor e javor të ndarjes së tregut, është mundësuar dhe kontrolli i lëshimit të policave të sigurimit për mjete me targë jo shqiptare. Aktiviteti i mësipërm është bashkërenduar me shoqëritë e sigurimit në mënyrë që të garantohet vazhdimësia e shërbimit.

Për vitin 2010 janë parashikuar shtesa në regjistër si funksione në shërbim të tregut në përgjithësi dhe shoqërive të sigurimit në veçanti. Ndër shtesat më të rëndësishme bën pjesë dhe mundësimi i shfaqjes automatike të të dhënave të mjeteve motorike dhe të pronarëve të tyre tek agjentët e shitjes, duke mundësuar uljen e kohës së lëshimit të policës, saktësimin e të dhënave dhe evitimin e rasteve të pasaktësive ose keq përdorimeve të mundshme.

Në planin e vitit 2010, të dhënat e regjistrit do të shërbejnë për kontrollin e mundshëm nga ana e policisë në kohë reale. Kjo ka një rëndësi të veçantë si për industrinë, për konsumatorët dhe për bashkëpunimin e frytshëm ndërinstitucional.

**Faza II: Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike**

Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike përbëhet nga platforma e raportimit online të dëmeve të ndodhura, në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike dhe është ndër arritjet më kryesore të institucionit gjatë vitit 2009. Regjistri i Dëmeve është krijuar me qëllim kryesor mundësimin e aplikimit të sistemit Bonus-Malus duke përdorur si një nga parametrat e tij "historikun e dëmeve". Baza historike e të dhënave mbi dëmet, mundëson liberalizimin e mundshëm të tarifave ose kalimin e mirëfilltë në përqasjen me bazë risku për përllogaritjen e kapitalit minimal të kërkuar për këto portofole, në varësi të riskut të marrë në sigurim. Regjistri mundëson raporte të ndryshme statistikore, të cilat do të krijojnë një pamje më të qartë dhe më të detajuar mbi përmbajtjen dhe aktivitetin tij.

Në mbrojtje të interesave të industrisë, regjistri nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave mundëson evidentimin e menjëhershëm të rasteve të mundshme të abuzimeve dhe vlerësim të klientëve në bazë të historikut të dëmeve.

Për nga rëndësia e vetë industrisë të sigurimeve ku dhe produkti përfundimtar është pagesa e dëmeve ndaj të dëmtuarve, kjo bazë të dhënash ndihmon në ngritjen e një shërbimi më cilësor ndaj të dëmtuarve, në evidentimin e riskut, evidentimin dhe shmangien e abuzimeve, respektimin e afateve kohore, si dhe studime të tregut për përgatitje të informacioneve statistikore.

Regjistri i Dëmeve është projektuar dhe zbatuar mbi të njëjtën arkitekturë funksionale me Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike për të mundësuar kryqëzimin e të dhënave të policave të shitura me dëmet e ndodhura. Kjo arkitekturë shfrytëzon në maksimum infrastrukturën hardware dhe licencimin e kryer gjatë fazës së parë të projektit. Realizimi efektiv i regjistrit u krye nga Autoriteti nëpërmjet Drejtorisë TI dhe fondeve vetjake, pa kosto për shoqëritë e sigurimit.

Projekti u përgatit në përshtatje me rregulloret dhe udhëzimet e miratuara nga Bordi i AMF-së në lidhje me trajtimin e dëmeve, duke ndërvepruar me shoqëritë e sigurimit në drejtim të marrjes së eksperiencës së tyre dhe të partnerëve ndërkombëtarë si ISVAP në Itali e Tramer në Turqi dhe me mbështetjen e Bankës Botërore.

Projekti, pas aprovimit të tij nga Bordi i AMF-së, u vu në përdorim brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Një punë e veçantë u krye për të mundësuar popullimin e regjistrit me të dhënat historike të dëmeve, kjo nëpërmjet realizimit të automatizimit të marrjes së të dhënave nga struktura informatike të ngjashme me ato ekzistuese të shoqërive të sigurimit. Si rezultat i punës së përbashkët, në fund të vitit 2009, Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike përmbante historikun e mbi 25000 dosje dëmesh duke filluar nga 1 janari i vitit 2006.

Për vitin 2010 janë parashikuar shtesa në regjistër si funksione në shërbim të shoqërive të sigurimit, raporte në shërbim të Autoritetit dhe funksione në shërbim të mirëmbajtjes së tij.

Një nga shtesat më të rëndësishme është kryqëzimi automatik i të dhënave të Regjistrit të Dëmeve dhe Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike duke raportuar në ndërfaqen e shoqërive të sigurimit rastet e mungesës së saktësisë ose të manipulimeve të mundshme.

**Faza III: Sistemi Bonus-Malus**
Në Qendrën Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik një rol të rëndësishëm në të ardhmen do të ketë dhe mundësimi i sistemit Bonus-Malus, me fokusim të veçantë mbi liberalizim të mundshëm të tarifave ose kalim të mirëfilltë në përqasjen me bazë risku. Të dhënat në dispozicion si rezultat i fazës së parë dhe të dytë të projektit do të përdoren si parametra në algoritmin Bonus-Malus i cili do të realizohet në vitin 2010.

Gjatë vitit 2009 është saktësuar zgjidhja teknike dhe integrimi i saj me Regjistrin e Shitjeve Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, përsa i përket parametrave të përllogaritjes së bonus-it dhe Regjistrin e Dëmeve, përsa i përket parametrave të përllogaritjes së malus-it.

## Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

Në kuadër të përmirësimit të raportimit elektronik të subjekteve në mbikëqyrje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me ndihmën financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) po zhvillon projektin "Management Information System" (MIS) në bashkëpunim me shoqërinë e zhvillimit të produkteve të raportimit "VIZOR".

Projekti nga ana teknike përbëhet nga një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës operatorët e shoqërive të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së internetit.



Strukturat e brendshme të institucionit, gjatë vitit 2009, kanë marrë pjesë intensive në procesin e ndërtimit te pjesëve të sistemit si forma e raporte, duke zhvilluar rreth 50% të tyre. Kjo me qëllimin e përfitimit të aftësisë zhvilluese në vazhdimësi dhe mundësimin e suportit, ndryshimeve dhe mirëmbajtjes së projektit pas përmbylljes së tij. Elementët hardware të nevojshëm, janë tashmë të instaluar në sallën e serverave të Autoritetit dhe të gatshëm për t'u përdorur nga shoqëria zbatuese. Një punë e veçantë është kryer në drejtim të identifikimit dhe realizimit të specifikave të rrjetit për të mundësuar përdorimin e sistemit, i cili aktualisht është në testimet e fundit.




## Sistemi telefonik i ndihmës së konsumatorëve

Një vend të rëndësishëm në aktivitetet e Teknologjisë së Informacionit zënë projektimi, zbatimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve.

Gjatë vitit 2009 është modifikuar dhe përshtatur "Sistemi telefonik i ndihmës së konsumatorëve" nëpërmjet konfigurimit të sistemit të përgjigjes automatike, në të cilin përfundojnë telefonatat nga numri telefonik i konsumatorit "+355 4 2269 329" i publikuar në faqen zyrtare të internetit **www.amf.gov.al** dhe nga numri pa pagesë "0800 6969".

Numri pa pagesë mundëson telefonatën nga shtëpitë e konsumatorëve pa kosto nga ana e tyre. Sistemi i instaluar e në funksionim:

- rrit në mënyrë të dukshme shërbimin ndaj konsumatorit dhe industrisë duke qenë gjithmonë pranë tyre 24 orë nga 24, 7 ditë nga 7;
- integron informacionin e dhënë në mënyrë automatike me trajtimin e çështjeve të veçanta direkt nga specialistët;
- standardizon trajtimin e çështjeve dhe edukimin e publikut;
- zbaton konceptin e auditimit hierarkik dhe kontrollit të drejtuesve mbi çdo çështje përfshirë dhe rendimentin e punonjësve.

Në varësi të informacioneve që vlerësohen si "të automatizueshme", në vitin 2010 do të zgjerohet bashkëpunimi midis strukturave të brendshme të Autoritetit, me qëllim përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorit.

Në të ardhmen, si zhvillim i mëtejshëm i sistemit, do të mundësohet kontrolli i sigurimit të mjetit direkt nga telefoni. Personave të interesuar do t'u kërkohet të shtypin në tastierën e telefonit targën e mjetit.

## Biblioteka Online

Gjatë vitit 2009 është modifikuar dhe përshtatur "Sistemi i Bibliotekës Online" nëpërmjet konfigurimit dhe përshtatjes së sistemit të kërkesave të Autoritetit.

Sistemi i instaluar e në funksionim aksesohet nga punonjësit nëpërmjet intranetit të brendshëm e web browser-it duke shfaqur përmbajtjen e bibliotekës dhe gjendjen e elementëve. Ndërfaqja e sistemit mundëson kërkimin e objekteve sipas interesit të punonjësit nëpërmjet autorit, përmbajtjes dhe automatizimin e njohjen e objekteve gjatë hyrjes apo daljes nga biblioteka. Aktualisht sistemi është në funksionim të plotë.

## Platformat dhe sistemet e AMF-së garantojnë

### Në drejtim të mbikëqyrjes

- Monitorimin në kohë reale të shoqërive të sigurimit në shitjen e policave të sigurimeve të detyrueshme dhe të dëmeve motorike.
- Kontrollin e korrektësisë së policave nga vetë klientët.
- Automatizimin e proceseve të punës dhe rritjen e efektivitetit të vendimmarrjes.
- Minimizimin e gabimeve teknike nëpërmjet njësimit të përdorimit të platformave të ndryshme nga AMF dhe operatorët e mbikëqyrur.
- Parametra të lartë të sigurisë, si nga ana fizike dhe funksionale.

### Në drejtim të efektivitetit të punës së instuticionit

- Standardizimin e infrastrukturës të rrjetit dhe të menaxhimit informatik të posteve të punës.
- Forcimin e shkallës së sigurisë së informacionit, duke marrë parasysh sistemet kritikë të ndërtuar dhe konfidencialitetin e të dhënave, nëpërmjet rritjes të sigurisë të infrastrukturës informatike dhe aplikimit të rregullave në aksesin dhe përdorimin e brendshëm.
- Licencimin e programeve për aktivitetin informatik të AMF-së në bashkëpunim dhe sipas direktivave të Institucioneve dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përdorimin e "paketave të programeve" të standardizuara në aktivitetin financiar të AMF-së dhe të njohura nga organet e kontrollit apo ato tatimore, duke bërë më transparent funksionimin e vetë Autoritetit.
- Informatizimin e vazhdueshëm të arkivës, si dhe dokumentacionit të protokolluar për të lehtësuar dhe mundësuar vazhdueshmërinë e përpunimit të materialeve me afate shqyrtimi relativisht të gjata.
- Automatizimin e procesit të vendosjes së të dhënave, nëpërmjet integrimit të produkteve më të avancuara, me rrjedhojë efektivitetin e lartë në përdorimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e tyre profesionale.



## 2.5 Bashkëpunimi institucional



Gjatë zhvillimit të takimit të AMF-së me institucione shtetërore për dy projektligjet e përgatitura nga AMF

### Bashkëpunimi me institucionet e vendit

AMF ka vijuar të mbajë bashkëpunim të ngushtë, në mënyrë të vazhdueshme, me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në përmbushje të misionit të **Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar**, me qëllim rritjen e efektivitetit të rregullimit të tregjeve financiare në Shqipëri.

Bashkëpunimi me **Ministrinë e Financave**, gjatë vitit 2009, ka qenë tepër i rëndësishëm dhe i suksesshëm, në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor të tre sektorëve që mbikëqyren nga AMF dhe veçanërisht në organizimin e takimeve të punës për diskutimin me institucionet shtetërore të projekteve ligjore të hartuara nga AMF, konkretisht: “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore “ dhe “Fondet e pensionit vullnetar”.

Bashkëpunimi me **Bankën e Shqipërisë** është shumë i rëndësishëm në drejtim të arritjes së objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në vend. Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit midis dy institucioneve dhe inspektimet e përbashkëta kanë rezultuar të suksesshme, duke konfirmuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi strategjik në drejtim të evidentimit të risqeve dhe transferimit të tyre brenda sektorit financiar.

Gjatë vitit 2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka mbajtur kontakte të rregullta me **Ministrinë e Integrimit Evropian** dhe ka përcjellë pranë raporte, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me acquis-in të akteve juridike të miratuara në fushën e tregut financiar jo-bankar. Konkretisht:

- raportim çdo 3 muaj pranë (me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integrimit) Komunitetit Evropian në lidhje me zhvillimet legjislative, masat, projektet dhe kapacitetet institucionale në lidhje me periudhën raportuese;
- raportim mujor në sistemin online në kuadër të PKZMSA dhe raportim e rishikim periodik të Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA, me një fokus të veçantë në aspektet që lidhen me afatet e përcaktuar sipas detyrimeve të MSA, si dhe adresimin e problematikës dhe rekomandimeve të Raport Progresit të Komisionit Evropian;
- raportim i vazhdueshëm në lidhje me fushat e mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AMF, duke ju dhënë përgjigje pyetjeve dhe kërkesave të ndryshme, të cilat i drejtohen Autoritetit nga Komisioni Evropian;
- raportim vjetor në lidhje me të gjitha zhvillimet e tregut të sigurimeve, të titujve apo pensioneve private të mbikëqyrura nga AMF për periudhën raportuese në fjalë;
- rishikim dhe përditësim me legjislacionin më të fundit komunitar në fushën e tregjeve të rregulluara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti.

## Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

AMF mban një komunikim të vazhdueshëm me homologët nëpërmjet kontakteve dhe shkëmbimit të eksperiencës. Pjesëmarrja gjithnjë e më aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë është një domosdoshmëri në njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit rregullative dhe mbikëqyrëse, si dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave më të mira. Një tjetër faktor i rëndësishëm në intensifikimin e kontakteve me homologët dhe institucionet ndërkombëtare ka qenë dhe nevoja e harmonizimit të legjislacionit rregullues të tregjeve financiare jo-bankare me Direktivat e BE-së, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

## Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të mbikëqyrësve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. Gjithashtu, AMF vijon të jetë pjesëmarrëse me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të dhënave të Ligjeve të IAIS-it, i cili lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t'u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare.

Viti 2009 shënoi dhe kurorëzimin me sukses të një pune intensive për t'u bërë pjesë e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit me IOSCO-n. Kështu, në qershor 2009, gjatë Konferencës së 34-vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Letrave me Vlerë (IOSCO) që u mbajt në Tel Aviv, AMF nënshkroi Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n duke u bërë anëtare e organizatës me të drejta të plota.

Ky anëtarësim është i një rëndësie të veçantë dhe ka ardhur pas një procesi të gjatë verifikimi, i cili solli nevojën e hartimit të një sërë aktesh rregullative. Nënshkrimi i marrëveshjes hap rrugën e madhe të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet homologe në mbarë botën, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi ishte një detyrim për të gjithë anëtarët e IOSCO-s dhe procesi i nënshkrimit të tij duhet të përfundonte brenda vitit 2010.

AMF si anëtare e IAIS-it (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve), është duke ndjekur me interes procesin e sapofilluar nga IAIS për nënshkrimin nga vendet anëtare, të Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit (MmoU) me IAIS. Rëndësia e procesit në tërësi dhe përfitimet që burojnë prej tij në drejtim të shkëmbimit të informacionit, si element kyç në forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, e kanë identifikuar atë si një hap të rëndësishëm strategjik në axhendën e AMF-së. Aplikimi do të vijë pas një sërë ndryshimesh ligjore të nevojshme, që duhen bërë në kuadrin ligjor të sigurimeve, në mënyrë që të harmonizohen kërkesat minimale, për t'u kualifikuar në procesin e nënshkrimit të marrëveshjes.



## Bashkëpunimi me institucione homologe

Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet homologe të rajonit e më gjerë, janë të domosdoshme në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF-së, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo-bankare.

Bashkëpunimi me **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK)**, ka hyrë në një fazë konsolidimi, dhe luan një rol tepër të rëndësishëm, sidomos në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në të dy vendet, pasi shoqëritë shqiptare të sigurimit kanë peshë jo të vogël në tregun kosovar. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis AMF dhe BQK ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit, ekspertizës dhe përvojës midis dy institucioneve.



Zj. E Gjoni dhe Z. Peter Braumüller në nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

KonsolidimiiinteresaveAustriakenëtregunShqiptar të sigurimeve ka hapur rrugën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës midis AMF dhe **Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë**. Ky bashkëpunim i suksesshëm midis dy institucioneve është konkretizuar në muajin korrik 2009, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Ministrisë Austriake të Financave e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve. Nënshkrimi i marrëveshjes është një hap strategjik tepër i rëndësishëm për AMF dhe mbi të gjitha është shprehje e bashkëpunimit institucional në mbikëqyrjen e përbashkët dhe shkëmbimin e informacionit midis rregullatorëve financiarë të të dy vendeve.

## Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët

Në kuadrin e realizimit të projekteve strategjike të institucionit, si dhe rritjes së kapaciteteve institucionale, bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e suksesshme me donatorët vazhdojnë të luajnë një rol tepër të rëndësishëm në këtë drejtim.



Zj. E Gjoni gjatë zhvillimit të seminarit mbi liberalizimin e MTPL-së, mundësitë dhe sfidat

Bashkëpunimi me **Bankën Botërore** ka qenë tepër i rëndësishëm në drejtim të kontributit të Bankës Botërore në projektet strategjike të AMF-së. Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" konkretizoi një punë intensive dhe bashkëpunim të frytshëm

midis dy institucioneve. Projekti i metodologjisë së mbikëqyrjes efektive dhe përmirësimit të bazës ligjore për tregun e sigurimeve ka hyrë në fazën e dytë dhe të fundit, në sajë të një pune intensive dhe bashkëpunimi të suksesshëm midis ekspertëve të Bankës Botërore dhe stafit të AMF-së. Në kuadër të këtij projekti, me mbështetjen e Bankës Botërore, në janar të vitit 2009 është organizuar dhe një cikël trajnimesh për stafin e AMF-së, në lidhje me njohjen e thellë dhe shikimin praktik mbi mbikëqyrjen me bazë risku, i cili më pas vijoi me vizita studimore pranë shoqërive të sigurimit dhe u mbyll me një seminar mbi të rejat më të fundit në fushën e mbikëqyrjes dhe sfidat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen efektive.

Në kuadër të bashkëpunimit me **FMN**, AMF ka ndjekur rekomandimet e vlefshme për hapat që duheshin hedhur deri në krijimin e kuadrit të plotë ligjor dhe hartimin e strategjisë së pensioneve private në Shqipëri. Këto rekomandime janë konkretizuar me hartimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar".

AMF e konsideron bashkëpunimin me strukturat e Evropës së Bashkuar si një element tepër të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat Evropiane. Në datën 19 dhjetor 2008, Komisioni Evropian miratoi Programin Kombëtar për Shqipërinë nën IPA 2008 - Komponenti i Asistencës së Tranzicionit dhe Ngritja e Institucioneve. Instrumenti për Para-Anëtarësim (IPA), përbën dhe asistencën financiare të BE-së. Nga ana e AMF-së janë bërë përpjekje për të përfituar mbështetjen e projekteve mbi forcimin e kapaciteteve institucionale nga programi IPA apo programi TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange) i Bashkimit Evropian. AMF ka përfituar vazhdimisht dhe do të vijojë të marrë asistencë nga instrumenti TAIEX, i cili kryesisht ofron asistencë teknike në fushën e përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit komunitar për vendet që janë kandidate ose kandidate potenciale për anëtarësim në BE, nëpërmjet organizimit të vizitave në vend të ekspertëve nga komuniteti evropian, organizimit të seminareve ose takimeve të ndryshme si dhe organizimit të vizitave studimore në institucionet e vendeve të BE-së.

Bashkëpunimi me **USAID** dhe me **Programin PFS** vijon të jetë i frytshëm, në drejtim të organizimit të një sërë evenimentesh në të cilat AMF është përfaqësuar.

AMF ka mbajtur një bashkëpunim të ngushtë me **FSVC (Financial Services Volunteer Corps)** edhe gjatë vitit 2009, konkretisht me zhvillimin e kursit të aktuaristikës, me qëllim përgatitjen e ekspertëve të kësaj fushe për tregun shqiptar të sigurimeve, si dhe me zhvillimin e projektit mbi zbatimin e ligjit "Për fondet e pensionit vullnetar".

Bashkëpunimi me **Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH)** është konkretizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore", projekt i cili është mbështetur financiarisht nga BERZH. Një projekt tjetër tepër i rëndësishëm i mbështetur financiarisht nga BERZH, është ai i zhvillimit të platformës së menaxhimit të informacionit për raportimin e institucioneve financiare jo-bankare, i cili gjatë vitit 2009 kryesisht ka qenë në proces testimi e përmirësimi, përpara se të vijojë instalimi i platformës dhe funksionimi normal i saj.



## 2.6 Integrimi Evropian

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si instrumenti i cili do të mundësojë integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, krijon kuadrin e duhur për forcimin e shtetit ligjor, rritjen e efikasitetit të tij, ndihmon reformat institucionale dhe ekonomike, me qëllim rritjen e standardeve të jetesës për të gjithë shtetasit. Me anë të kësaj marrëveshjeje Shqipëria synon arritjen e standardeve, të cilat do të garantonin statusin e saj si vend kandidat dhe më pas asociimin në Bashkimin Evropian.

MSA hyri në fuqi më 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së, të cilat ishin pjesë e komunitetit në momentin e nënshkrimit të MSA, si dhe miratimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon adoptimin e acquis communautaire (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional, që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm evropian me synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë. Ky përafrim i legjislacionit parashikohet të bëhet në dy faza 5-vjeçare sipas një programi të detajuar, i cili përditësohet duke marrë parasysh realizimin e objektivave, si dhe vetë ndryshimet në të drejtën Komunitare.

Për zbatimin të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2009-2014.

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare jo-bankare, si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (acquis communautaire) në këto fusha.

Neni 70 i MSA-së parashikon detyrimin për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë gjatë fazës së parë tranzitore. Në nenin 50 të saj, Shqipëria është angazhuar që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, t'u ofrojë shoqërive komunitare si dhe degëve dhe filialeve të tyre një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u njihet kompanive, degëve apo filialeve shqiptare. Gjithashtu, në nenin 57 të Marrëveshjes, Shqipëria angazhohet të lejojë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë komunitare, pa qenë nevoja për t'u vendosur.

- Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2009-2014 (PKZMSA 2009-2014) trajton në tërësinë e tij të gjitha prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Shqipërisë në procesin e Integrimit Evropian.

- Çdo fushë e PKZMSA 2009-2014 përbëhet nga pjesa hyrëse dhe nga pjesa programuese mbi iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese që do të ndërmerren për çdo sektor apo fushë, sipas prioriteteve të përcaktuara në dokumentet e Partneritetit Evropian, MSA-së dhe kapitujve të acquis për çdo periudhë kohore afatshkurtër (2009-2010), afatmesme (2011-2012) dhe afatgjatë (2013-2014) nga shteti shqiptar.

Vendimi i Këshillit për parimet, kushtet dhe përparësitë të përmbajtura në Partneritetin Evropian me Shqipërinë, përcakton si përparësi afatshkurtër në fushën e shërbimeve financiare forcimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës në sektorin e sigurimeve.

Në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, 2007-2012, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vijoi punën për nismat ligjore dhe veprimtaritë zbatuese që duhet të ndërmerren nga ana e saj. Kështu, gjatë vitit 2009, me përfundimin e draftimit të tre ligjeve të poshtë përmendura është bërë përpjekje që të arrihet transpozimi i plotë i të gjitha direktivave të cilat kanë të bëjnë me fushat specifike, të cilat mbikëqyren nga Autoriteti dhe gjithashtu një respektim i të gjitha angazhimeve të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit:

Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore. Ky ligj u përafrua me Direktivën 2004/109/EC "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta" e cila amendon Direktivën 2001/34/EC, Direktivën 2003/71/EC "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar" që amendon Direktivën 2001/34/EC dhe Direktivën 2004/39/EC (MiFID) "Mbi tregjet e instrumentave financiarë".

MSA, ndërmjet komuniteteve evropiane të shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, deri në momentin e hyrjes së saj në fuqi ka kaluar në këto hapa:

- 12 qershor 2006, në Luksemburg, u nënshkrua teksti i plotë i marrëveshjes për 135 nenet, 5 anekset dhe 6 protokollet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, si dhe i Marrëveshjes së Përkohshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar
- kuadri i përgjithshëm i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përbëhet nga katër shtylla: dialogu politik dhe bashkëpunimi rajonal, dispozitat tregtare lidhur me liberalizimin progresiv të këmbimeve deri në vendosjen e një zone tregtie të lirë midis palëve, liritë komunitare dhe së fundi bashkëpunimi në fushat prioritare sidomos në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme
- ecuri e procesit të negociatave për marrëveshjen e stabilizim-asociimit (janar 2003-dhjetor 2005)
- në pritje të përfundimit të procesit të ratifikimit të MSA-së, me procedura të përshpejtuara, hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006, Marrëveshja e Përkohshme, e cila lidhet vetëm me provizionet tregtare
- MSA hyri në fuqi më 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së
- procesi i ratifikimit u krye në më pak se 3 vjet dhe u finalizua me ratifikimin e marrëveshjes nga parlamenti grek në 15 janar 2009, duke i hapur kështu rrugën Shqipërisë drejt aplikimit në BE për marrjen e statusit të vendit kandidat
- kërkesa për anëtarësimin e Republikës Shqipërisë në BE dorëzohet në 28 prill 2009
- dhjetor 2009 Qeveria Shqiptare merr në dorëzim Pyetësorin e KE-së



Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Ky Ligj u përafrua me Direktivën 85/611/EEC "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm" e amenduar nga Direktivat 88/220/EEC dhe 95/26/EC.

Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar". Ligji është mbështetur në Direktivën 85/611/EEC "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm", Direktivën 2003/41/EC "Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale" dhe Direktivën 2004/39/EC "Mbi tregjet e instrumentave financiarë".

AMF ka marrë pjesë rregullisht në takimet e përbashkëta Shqipëri-BE lidhur me monitorimin e zbatimit të MSA-së. AMF prezantoi zhvillimet më të fundit legjislative të tregut financiar jo-bankar dhe të kapaciteteve institucionale të tij në takimin për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën në 29 prill 2009 në Bruksel.

Gjithashtu, në kuadrin e zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë, nga kjo e fundit ishte parashikuar që brenda vitit 2009 nga ana e Shqipërisë të përgatitet një raport periodik (në parim çdo 6 vjet) për vlerësimin e politikave tregtare nga momenti i anëtarësimit. Në këtë kuadër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në muajin nëntor 2009 paraqiti një raport në takimin e zhvilluar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me përfaqësues të OBT në Tiranë, duke bërë një prezantim të zhvillimeve legjislative në kuadrin e plotësimit të angazhimeve që burojnë edhe nga anëtarësimi në këtë organizatë.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (1 prill 2009) dhe dorëzimit të kërkesës për anëtarësim në BE (28 prill 2009), Qeveria Shqiptare duhet t'i përgjigjej sfidave të reja për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Procesi i përgjigjeve që institucionet shtetërore do t'i jepnin pyetjeve të Pyetësorit të KE-së, që është edhe hapi i parë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, përbën një nga sfidat më të rëndësishme në drejtim të përmbushjes së kritereve për të përftuar statusin e vendit kandidat.

Procesit të dhënies së përgjigjeve të pyetësorit i parapriu një periudhë përgatitore, sikundër ishin takime dypalëshe apo shumëpalëshe me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integrimit, me qëllim koordinimin e procesit. Gjatë kësaj periudhe përgatitore krahas nëpunësve të administratës shtetërore u trajnuan edhe punonjës të AMF-së që do të merrnin pjesë në këtë proces, në lidhje me metodologjinë e hartimit të përgjigjeve dhe rregullat e formulimit të përgjigjeve. Nga ana e tij, Autoriteti, pas daljes së Urdhrit të Kryeministrit nr. 183, datë 11.12 2009, "Për ngritjen e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës", filloi punën përgatitore për koordinimin e procesit të hartimit të përgjigjeve të Pyetësorit, duke ngritur për këtë qëllim grupin e tij të punës me Urdhrin nr. 83, datë 02.12.2009.

Në këtë proces u përfshinë mbi 20 specialistë të AMF-së, ndërsa disa nëpunës të tjerë u përfshinë në procesin e grumbullit të informacionit, ndihmë teknike për portalin, etj. Gjithashtu, Autoriteti, nëpërmjet strukturës së tij menaxhuese dhe koordinuese, punoi për

koordinimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi me institucione të tjera shtetërore të përfshirë në dhënien e përgjigjeve, për të shmangur çdo vonesë apo pasaktësi në dhënien e tyre.

Në Kapitullin 9 "Shërbimet Financiare" Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u caktua si koordinator i këtij kapitulli. Institucionet kontribuese për këtë kapitull janë: AMF, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.
Kapitulli 9 përmban 92 pyetje nga të cilat 65 pyetje i përkasin AMF-së, 26 Bankës së Shqipërisë dhe 1 pyetje, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe është i ndarë në katër pjesë.
Pjesa e parë "Bankat dhe konglomeratet Financiare".
Pjesa e dytë "Sigurimet dhe pensionet private".
Pjesa e tretë "Infrastruktura e Tregut Financiar".
Pjesa e katërt "Tregu i letrave me vlerë dhe shërbimet e investimeve".

Pyetjet e këtij kapitulli përfshijnë rregullat për licencimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të kreditit, të shoqërive të sigurimit të jetës dhe jo-jetës, pensioneve private dhe fondeve të investimeve.

## 2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca

AMF, gjatë vitit 2009, ka punuar në mënyrë të pandërprerë për rritjen e cilësisë së informacionit dhe transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimit financiar në përmbushje të rolit themelor: Mbrojtjes së konsumatorit.

Një konsumator, i cili disponon njohuritë bazë dhe informacionin e duhur, është në gjendje të përzgjedhë produktin që i përgjigjet më mirë nevojave të tij. AMF praktikon një sërë formash dhe mënyrash në përmbushjen e një komunikimi efektiv me publikun, ku mund të përmenden fletëpalosjet që përmbajnë informacion edukativ dhe statistikor të strukturuar, në lidhje me tregjet nën juridiksionin e AMF-së. Gjithashtu, publikimet e ndryshme me karakter informativ dhe edukativ kanë synuar njohjen e konsumatorëve me tregun financiar jo-bankar, mënyrën e funksionimit të tij, mbështetur dhe nga një faqe interneti interaktive, e cila e përmbush më së miri funksionin e saj në drejtim të komunikimit me të gjitha palët e interesit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet përditësimit të faqes zyrtare me informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e AMF-së dhe Bordit, lajme dhe njoftime me karakter orientues dhe mbrojtës për publikun, materiale dhe informacione edukuese për produktet financiare jo-bankare dhe rëndësinë e tyre. AMF ka pasur një prezencë aktive në median e shkruar dhe elektronike, si një instrument për të komunikuar zhvillime të rëndësishme në tregjet financiare jo-bankare apo dhe për të qenë palë në dialogun mes grupeve të interesit për zhvillimin e këtyre tregjeve. Media e shkruar dhe elektronike ka shërbyer gjithashtu për të përcjellë mesazhin e AMF-së publikut, në funksion të fushatave sensibilizuese, në drejtim të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit.



Faqja zyrtare e AMF-së i jep mundësi edhe përdoruesit të huaj të marrë informacionin e dëshiruar, pasi ajo është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.

**Botimet e AMF-së**

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar

**Publikime elektronike të AMF-së**

- Periodiku i AMF-së
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private suplementare

**Së Shpejti**

- Sigurime - 10 Vjet Statistika

*Ky publikim do të përmbajë 10 vjet statistika të përpunuara për tregun e sigurimeve*

Viti 2009 ka qenë një vit intensiv në drejtim të rritjes së gamës së publikimeve dhe prezantimit të botimeve të reja. Krahas botimeve të përvitshme është bërë një punë e madhe për rritjen e cilësisë së informacionit, si dhe pasurimin e publikimeve me elementë të rinj, me qëllim përfshirjen e sa më shumë përdoruesve dhe reagimit ndaj nevojës në rritje të tregut dhe investitorëve për informacion sa më cilësor dhe të specializuar.

**Buletini Zyrtar 2006 - 2008** është një publikim i veçantë realizuar për herë të parë nga AMF dhe vëllimi i parë përmban vendimet e miratuara nga Bordi i AMF-së gjatë periudhës 2006-2008. Nëpërmjet këtij publikimi synohet njohja e vazhdueshme e publikut dhe grupeve të interesit me aktivitetin rregullues, mbikëqyrës dhe institucional të AMF-së. Ky publikim do të vijojë të botohet, me periodicitet vjetor në vitet në vazhdim. Krahas këtij publikimi, një rubrikë e veçantë është parashikuar në faqen zyrtare të internetit dhe funksionon normalisht, ku vendimet e Bordit të AMF-së, afishohen pas çdo mbledhje Bordi.




Publikime të AMF-së

**Gjeografia e Sigurimeve** ka njohur përmirësime të mëtejshme dhe pasurim me elementë të rinj, ku përveç informacionit mbi dendësinë e sigurimeve, shpërndarjen e primeve dhe produkteve të sigurimit sipas prefekturave, është përfshirë edhe një informacion i detajuar për dëmet e paguara gjatë vitit 2008 sipas zonave gjeografike, si dhe është strukturuar më tej informacioni mbi shpërndarjen e primeve, duke mundësuar krahasimin me periudhën e një viti më parë. Një strukturim i tillë i informacionit bën të mundur analizimin më të mirë të tregut të sigurimeve sipas prefekturave, duke i ardhur në ndihmë mbikëqyrjes në lidhje me evidentimin e përqendrimit të tregut dhe shpërndarjes së risqeve.

Raportet periodike statistikore e financiare, që AMF publikon, japin një pamje të qartë të dinamikës së zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare dhe plotësojnë nevojat për informacion me karakter tekniko-financiar, për një numër të gjerë përdoruesish. Këto

raporte janë në dy gjuhë, përkatësisht shqip dhe anglisht, në mënyrë që dhe investitorët, apo analistët e huaj të kenë një dritare informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri.

Qendra e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, u mundëson mbajtësve të mjeteve motorike, verifikimin e policave të sigurimit të detyrueshëm nëpërmjet rubrikës "Verifiko policën tënde", në faqen zyrtare të AMF-së. Nëse polica e sigurimit nuk rezulton në sistem, konsumatori mund të depozitojë ankesë në rrugë elektronike.

Publikimi i projekteve ligjore në proces në faqen zyrtare të AMF-së, para miratimit të tyre, ka rezultuar një mënyrë efikase dhe transparente komunikimi në mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjitha palët e interesit dhe publikut të gjerë. Viti 2009 është karakterizuar nga një sërë nismash të rëndësishme ligjore me ndikim të pritshëm në tregjet financiare jo-bankare, ku reagimi i palëve të interesit është vlerësuar si faktor tepër i rëndësishëm gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të projekteve.

AMF ka vijuar të informojë publikun nëpërmjet periodikut elektronik mujor, i cili përmban informacione të larmishme në lidhje me zhvillimet e sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri, si dhe me zhvillimet dhe tendencat globale më të fundit të rregullimit të tregjeve financiare jo-bankare. Periodiku përmban dhe një rubrikë të veçantë për edukimin e konsumatorit, ku kryesisht përfshihen punime mbi shërbimet dhe produktet financiare, të cilat janë nën juridiksionin e AMF-së. Po kështu, një rubrikë i kushtohet dhe praktikave më të mira të përshtatura nga tregjet e ndryshme dhe shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe komunikimit të reformave palëve të interesit apo dhe prezantimit të strategjive me ndikim të pritshëm në tregjet nën juridiksionin e AMF-së. Kryesisht mund të përmendet:

- Takimi i punës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, për diskutimin e komenteve të institucioneve shtetërore, lidhur me tre projektligjet: "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore " dhe "Fondet e pensionit vullnetar", të draftuara nga AMF. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, Ministria e Integrimit, Ministria e Brendshme, Banka e Shqipërisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe konsulentë lokalë të angazhuar në përgatitjen e projektligjeve.

- Prezantimi i **sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes**, **AMF In-Reg**, i cili po ndërtohet nga AMF mbështetur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe financuar nga Fondi i Ballkanit Perëndimor. Gjatë takimit



u demonstrua funksionimi i platformës elektronike të raportimit dhe elementeve përbërës, deri në detaje. Prezantimi i sistemit u ndoq me mjaft interes e pati diskutime, nga Drejtorët e Përgjithshëm të Shoqërive të Sigurimit, Brokerimit, Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, Bankës së Shqipërisë, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, etj.

- Prezantimi i strategjisë së liberalizimit të MTPL, nëpërmjet aktivitetit me temë **"Liberalizimi i MTPL, mundësitë dhe sfidat".** Nisur nga pesha dhe rëndësia që MTPL ka në tregun shqiptar, sikurse dhe në shumë vende në zhvillim, rruga drejt liberalizimit të tarifave kalon nëpërmjet një sërë sfidash, kapërcimi i të cilave kërkon midis të tjerave një komunikim efikas midis rregullatorit dhe tregut. Qëllimi i këtij takimi ishte komunikimi me tregun e sigurimeve për të diskutuar dhe analizuar skenarët e mundshëm që duhet të shoqërojnë një proces të drejtë. Temat e trajtuara u ndoqën me mjaft interes e pati diskutime nga Drejtorët e Përgjithshëm të Shoqërive të Sigurimit dhe drejtues të tyre në sektorët e financës, aktuaristikës, si dhe Drejtues të Shoqërive të Brokerimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, etj.






Seminar mbi liberalizimin e MTPL-së, mundësitë dhe sfidat

- Prezantimi i Ligjit të ri **"Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore"** në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga ambasadat e huaja në vend, ministritë e linjës, Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, Dhoma e Tregtisë, biznese të mëdha në vend, etj. Prezantimi u ndoq me interes dhe u shoqërua me mjaft diskutime.

# Kapitulli 3
# Mbrojtja e Konsumatorit

## Mbrojtja konsumatore një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Mbrojtja e konsumatorit ka qenë një nga prioritetet strategjike të Autoritetit edhe gjatë vitit 2009. Mbrojtja e konsumatorit ka qëllim rritjen e besimit të publikut në përdorimin e produkteve financiare jo-bankare.
Një hap i rëndësishëm për realizimin e këtij qëllimi është zhvillimi i mëtejshëm i strategjisë për të krijuar një përqasje ligjore, një informacion të vazhdueshëm, transparencë, si dhe edukim të vazhdueshëm të konsumatorit.
Këto masa parandaluese në raport me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, janë dhe një promovim në lidhje me efikasitetin dhe transparencën e shërbimeve financiare.

Gjatë vitit 2009, Autoriteti ka shtuar mjetet e tij në mënyrë që të vazhdojë t'i sigurojë konsumatorit gjithë informacionin e nevojshëm, transparencën e vazhdueshme, me synimin që konsumatori të jetë komod në vendimet që do të marrë në lidhje me zgjedhjen e tij.
Autoriteti ndihmon konsumatorin sa më shumë të jetë e mundur duke ndërhyrë pranë subjekteve financiare jo-bankare për të korrigjuar një gabim apo për të shpjeguar rrugën ligjore në mënyrën lehtësisht më të kuptueshme.

Nëse subjekti është në shkelje të rregullave, Autoriteti paraqet masa parandaluese për të eliminuar shkeljet në të ardhmen.

*Mjetet e Autoritetit në funksion të mbrojtjes konsumatore*





**Njësia e Mbrojtjes së Konsumatorit**

Për të marrë një informacion, këshilla apo për të paraqitur një ankesë, pranë strukturës së Autoritetit, ekziston Njësia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Njësia e Mbrojtjes së Konsumatorit siguron një sërë parimesh të përgjithshme dhe rregulla të hollësishme në lidhje me marrëdhënien e tij me konsumatorin. Njësia e Mbrojtjes Konsumatore i kushton një rëndësi të veçantë shqyrtimit apo zgjidhjes së ankesave të paraqitura nga palët e dëmtuara, personave juridikë apo individëve që i ofrohen shërbime nga shoqëritë e sigurimit apo ndërmjetësit në sigurime. Ankesa të tilla shpesh janë informacion në procesin e mbikëqyrjes.

Duke shtuar mjetet e komunikimit me konsumatorin, gjatë vitit 2009 janë trajtuar rreth 70 ankesa, ku përfshihen dhe sqarime, çështjet kryesore të cilat kanë të bëjnë me vonesat e trajtimit të dëmshpërblimeve, refuzimin e ngjarjes së sigurimit, sqarime apo shkelje të kushteve të kontratave të sigurimit, ndryshim të rrethanave të ngjarjes së sigurimit, përllogaritjen e masës së dëmshpërblimit, etj. Nga këto ankesa janë zgjidhur përfundimisht rreth 60% e tyre.

Më poshtë paraqitet një grafik i numrit të ankesave për vitet 2007 - 2009, si dhe zgjidhjet e tyre me ndërhyrjen e Autoritetit.

**Grafiku i ankesave dhe zgjidhjet 2007 - 2009**




**Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik**

Çdo person i siguruar mund të verifikojë vlefshmërinë e kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik. Në këtë rubrikë jepen sqarime në lidhje me shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm, ekzistencën e një kodi numrash dhe shifrash me 15 karaktere që përbën dhe kodin identifikues të raportimit të gjeneruar automatikisht në kohë reale nga serverat e Autoritetit.

## Sistemi telefonik i Mbrojtjes së Konsumatorit

Numri telefonik i konsumatorit është i publikuar prej vitesh në faqen zyrtare të Autoritetit. Sistemit telefonik në mbrojtje të konsumatorit, me Vendimin e Bordit nr. 107, datë 25.11.2009, i është shtuar Numri jeshil, i cili ka për qëllim mundësimin dhe aksesimin e shërbimeve pa pagesë nga ana e konsumatorëve.

Për këtë qëllim është ngritur një sistem ku përfundojnë linjat telefonike të cilësuara më sipër, menaxhohen mesazhet zanore, menaxhohet ndërlidhja e telefonatave me sektorët e institucionit, aksesohen mesazhet e regjistruara dhe veprimet e ndërmarra si rrjedhojë e tyre.



# PJESA II
# TREGJET E MBIKËQYRURA

## II.1 Tregu i sigurimeve

### Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2009 vijuan të ushtrojnë veprimtarinë dhjetë shoqëri sigurimi, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës dhe një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës.

**Zhvillimi i tregut të sigurimeve në vite**

*(në mln lekë)*




| | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Dëme të paguara bruto* | 783 | 710 | 736 | 859 | 1,307 | 1,038 | 1,227 | 1,287 | 1,294 | 1,571 | 1,725 |
| *Prime të shkruara bruto* | 1,847 | 2,017 | 2,967 | 3,804 | 3,755 | 4,151 | 4,011 | 4,542 | 5,948 | 7,076 | 7,877 |

Në vitin 2009 primet e shkruara bruto kapën shifrën 7.9 miliardë lekë, ose rreth 11% më shumë se shifra përkatëse e vitit 2008. Rreth 7.2 miliardë lekë ose 91% e totalit të volumit të primeve të tregut i takojnë sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa 0.7 miliardë lekë ose 9% e totalit të tregut i takon sigurimeve të Jetës.

Viti 2009 vazhdoi te zbusë raportin e strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 47% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 53% të tregut, ku në krahasim me dy vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin përkatësisht 56% dhe 65% të tregut.

### Struktura e tregut të sigurimeve 2009







Në vitin 2009 u nënshkruan rreth 756 mijë kontrata sigurimi, ose gati 10% më shumë se në vitin 2008.

### Tabelë 11: Primet e shkruara bruto 2009

| | *Lloji i sigurimit* | *Numri i kontratave* | *Primet e Shkruara Bruto (në mln lekë)* | *Primet e Shkruara Bruto (konvertuar në mijë euro)* |
|---|---|---|---|---|
| **A** | Sigurime të detyrueshme | 391,852 | 4,191 | 30,554 |
| **B** | Sigurime vullnetare | 363,817 | 3,686 | 26,874 |
| *B1* | *Sigurimi i jetës* | *66,176* | 721 | 5,255 |
| *B2* | *Sigurimi i jo-jetës* | *297,641* | 2,965 | 21,619 |
| **GJITHSEJ** | | **755,669** | **7,877** | **57,428** |

## Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2009, sigurimet e detyrueshme motorike (të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta) vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë rreth 53% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit MTPL e brendshme, në vitin 2009, arritën në rreth 2.7 miliardë lekë, ose rreth 0.3% më shumë se në vitin 2008.

Në vitin 2009, primet e shkruara bruto të portofolit Kartoni Jeshil ishin rreth 1.05 miliardë lekë, ose rreth 11.34% më shumë se në vitin 2008. Ky produkt tregtohet në bazë të tarifave fikse, të cilat janë të detyrueshme për operatorët në treg.



**Zhvillimi i sigurimeve të detyrueshme në vite**




| | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ *Prime në milionë lekë* | 1,564 | 1,545 | 2,079 | 2,675 | 2,865 | 2,968 | 2,576 | 2,973 | 3,868 | 3,995 | 4,191 |

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2009 arritën në rreth 0.4 miliardë lekë, apo rreth 25.11% më shumë se në vitin 2008.

## Sigurimet vullnetare

Në vitin 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në rreth 3.7 miliardë lekë, ose 19% më shumë se të ardhurat e një viti më parë. Kjo rritje ndjehet si në sigurimet vullnetare te Jo-Jetës po ashtu dhe në sigurimet e Jetës.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës me të ardhura rreth 3 miliardë lekë, vendin e parë e zunë zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 27%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me rreth 23% të të ardhurave të këtij grupi, sigurimi kasko me rreth 20% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në 2009 arritën në rreth 375 milionë lekë, ose rreth 20% më shumë se në vitin 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 75% të të ardhurave të këtij grupi. Futja e investitorëve të huaj në treg këto vitet e fundit, ka pasur ndikimet e veta në drejtim të prezantimit të një game të re produktesh vullnetare, të cilat kanë gjetur hapësirat e duhura në treg.

Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2009 arritën në rreth 721 milionë lekë, ose rreth 40% më të larta se në vitin 2008. Sigurimi i Jetës vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të

## Zhvillimi i sigurimeve vullnetare të jo-jetës në vite




| | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Prime në milionë lekë* | 279 | 464 | 714 | 844 | 804 | 1,069 | 1,196 | 1,267 | 1,670 | 2,567 | 2,965 |

kredidhënies, kryesisht për individët. Ky fakt mbështetet dhe me analizimin e produkteve, që patën ndikimin kryesor në rritjen e këtij tregu. Kështu 43% e rritjes ka ardhur nga portofoli "Jetë Debitori", ku përfitues janë bankat e nivelit të dytë, të cilat i akordojnë kredi individëve dhe rreth 40% e rritjes vjen nga portofoli "Jetë me kursim". Rritja e primeve të shkruara bruto në portofolin e sigurimit "Jetë Debitori" është 23% më shumë se në vitin 2008, e shoqëruar kjo dhe me një rritje të numrit të kontratave në masën 34%. Në portofolin "Jetë me kursim" gjatë vitit 2009 është vënë re një shumëfishim i primeve të shkruara bruto dhe i numrit të personave që bëjnë sigurim jete.

## Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës në periudhën 2007 - 2009

*(në mln lekë)*





## Shpërndarja gjeografike e sigurimeve

Duke i hedhur një vështrim primit të shkruar bruto sipas shpërndarjes gjeografike, vihet re një përqëndrim i tregut të sigurimeve në Prefekturat e mëdha.

Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2009 është rreth 2,443.28 lekë për frymë me një rritje prej 216.65 lekë krahasuar me një vit më parë.
Përsa i përket primit për frymë sipas Prefekturave, prefektura e Tiranës, me 5,748 lekë për frymë, zë vendin e parë e pasuar nga prefektura Gjirokastër me 3,401 lekë për frymë dhe më tej Durrësi dhe Korça përkatësisht me 2,119 lekë për frymë dhe 1,798 lekë për frymë.

### Dëmet

Gjatë vitit 2009 shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 1.72 miliardë lekë dëme, ose rreth 10% më shumë se në 2008. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve të detyrueshme motorike me 1.05 miliardë lekë, apo 61% të totalit. Pavarësisht rritjes në vlerë absolute të dëmeve të paguara bruto, raporti i ulët dëme/prime tregon se tregu ka ende shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.




**Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave**

**Dëmet e paguara sipas prefekturave**



### Struktura e dëmeve të paguara 2009




### Pagesat e dëmeve nga shoqeritë e sigurimit në vite

*(në mln lekë)*




| | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Sigurime të detyrueshme* | 715 | 632 | 635 | 711 | 1,096 | 857 | 863 | 991 | 874 | 933 | 1,058 |
| *Sigurime vullnetare* | 69 | 78 | 101 | 147 | 211 | 181 | 364 | 296 | 419 | 638 | 667 |

### Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2009, tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës u nda ndërmjet shoqërive të sigurimeve: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30% të primeve të shkruara bruto.



Ndarja e tregut të sigurimeve të jo-jetës në 2009




Ndarja e tregut të sigurimeve të Jetës në 2009




Gjatë vitit 2009, aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me rreth 55% të primeve të shkruara bruto.

## Risigurimet

### Rreziqet e kontraktuara dhe mbulimi me risigurim

Gjatë vitit 2009 shoqëritë e sigurimit kanë kontraktuar rreziqe të cilat i përkasin si sigurimit të pasurive të ndryshme, sigurimit të bankave, sigurimit të marinës e aviacionit, sigurimit të jetës, ashtu edhe sigurimit të përgjegjësive, siç është rasti i ndërtimit të rrugëve të ndryshme gjatë gjithë territorit të vendit, apo sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta të drejtuesve të automjeteve si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil.

Lidhur me këto rreziqe, Autoriteti ka monitoruar mënyrën e administrimit të rrezikut prej shoqërive të sigurimit, si nëpërmjet kontrollit mbi dokumenta edhe kontrollit pranë shoqërive të sigurimit, të cilat kanë përdorur kapitalet e nevojshme e kanë kryer diversifikimin e portofoleve të sigurimit. Gjithashtu, nëpërmjet bashkësigurimit dhe kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi dhe mbulimit me risigurim fakultativ në kontrata të veçanta, në funksion të rritjes së kapacitetit të tyre dhe zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha.
Marrëveshjet risiguruese në porotofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë si të formës jo proporcionale të tipit Excess of Loss, ashtu edhe të formës proporcionale të tipit Quota Share e Surplus.
Ndërkohë, në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit Surplus e të tipit Quota Share.

AMF ka monitoruar marrëveshjet risiguruese dhe kontratat fakultative të risigurimit, në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguruesve.

Më shumë se 80% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BBB në Standard & Poors, nga ku mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A. Ndër pjesëmarrësit kryesorë në këto programe risigurimi mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Scor, Lloyd's Syndicates, etj.

**Krijimi dhe mbajtja e përshtatshme e provigjoneve teknike e matematike të sigurimit**

Një pikë shumë e rëndësishme për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes financiare të shoqërive të sigurimit janë analizat periodike lidhur me mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike e matematike. Lidhur me këtë, AMF ka monitoruar me kujdes përllogaritjet e provigjoneve teknike e matematike gjatë gjithë vitit 2009, ku dhe janë kryer takime të përbashkëta me aktuarët e shoqërive të sigurimit për metodat më të mira të përdorshme lidhur me përllogaritjen e tyre.

**Komiteti i Aktuarëve**

Në zbatim të Ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Rregullores "Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar me Vendimin e Bordit nr. 75, datë 28.08.2009, Autoriteti shqyrton dhe miraton propozimin e Komitetit të Aktuarëve si grup konsultativ, lidhur me tarifat e sigurimit të detyrueshëm MTPL.

## II.2 Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), është i vetmi treg aktiv në tregun financiar në Shqipëri, ndërsa tregu i aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar. Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë) mundëson informacion të përditësuar me bazë ditore, në lidhje me transaksionet, kuotimet, çmimet dhe rezultatet në lidhje me këto letra me vlerë. Të gjithë ndërmjetësit financiarë, të licencuar për të operuar në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, janë të detyruar të publikojnë të gjithë informacionin e mësipërm nëpërmjet platformës GSRM.



## Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Tregu sekondar (transaksionet e llojit B dhe C) i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2009 u dominua në masën 89.41% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 10.59% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 97.24% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.
Transaksionet "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" dhe "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2009, përkatësisht në masën 43.20% dhe 32.13% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 96.32% të të gjitha transaksioneve në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominojnë këtë treg në raport me personat juridikë.

**Tabelë 12: Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë**

| *Lloji i Transaksionit* | | *Vlera nominale (në mln lekë)* | | *Ndryshimi (në %)* |
|---|---|---|---|---|
| *Letra me Vlerë të Qeverisë* | | *2008* | *2009* | *`09 /`08-1* |
| A | **Blerje në tregun primar** | **7,199.20** | **8,601.04** | **19.47** |
| | *Individë* | 5,588.12 | 6,723.89 | 20.32 |
| | *Persona juridikë* | 1,611.08 | 1,877.15 | 16.52 |
| B | **Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar** | **8,457.89** | **20,367.23** | **140.81** |
| | *Individë* | 6,693.88 | 8,196.13 | 22.44 |
| | *Persona juridikë* | 1,764.00 | 12,171.10 | 589.97 |
| C | **Blerje nga individët para afatit të maturimit** | **617.90** | **2,950.54** | **377.51** |
| | *Individë* | 604.31 | 1,052.54 | 74.17 |
| | *Persona juridikë* | 13.59 | 1,897.99 | 13,871.25 |
| D | **Vendosje e bonove si kolateral** | **97.63** | **82.74** | **(15.25)** |
| | *Individë* | 84.03 | 67.99 | (19.08) |
| | *Persona juridikë* | 13.60 | 14.75 | 8.43 |
| E | **Shlyerje e vlerës nominale në maturim** | **6,167.63** | **15,150.27** | **145.64** |
| | *Individë* | 5,709.81 | 8,988.70 | 57.43 |
| | *Persona juridikë* | 457.82 | 6,161.57 | 1,245.86 |

## Platforma GSRM (Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë)

Platforma GSRM tashmë ka tre vite që është projektuar dhe ndërtuar nga AMF, në mënyrë të tillë që të sigurojë rritje të transparencës në lidhje me kuotimet dhe transakionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve. Ky objektiv është realizuar me sukses, pasi platforma tashmë funksionon normalisht dhe një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe ndërgjegjësimi i lartë i subjekteve të licencuara nga AMF për të operuar në këtë treg, në lidhje me përfitimet nga transparenca dhe publikimi në kohë reale i të dhënave mbi kuotimet dhe transakionet e ekzekutuara çdo ditë.

Platforma GSRM është kthyer në një nga rubrikat me interes më të lartë nga vizitorët e shumtë të faqes zyrtare të internetit të AMF-së, duke zënë rreth 17% të gjitha vizitave. Interesi i publikut për platformën GSRM ka ardhur në rritje, gjë që vihet re në numrin e vizitorëve gjatë vitit 2009, i cili ka një rritje në masën 7%, krahasuar me një vit më parë.

Platforma GSRM jep një informacion të plotë dhe të përditësuar për publikun dhe investitorët institucionalë në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë. Në këtë platformë, përfshihet dhe një bazë e të dhënave historike, e cila i vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna dhe për qëllime statistikore apo akademike.

Kjo rubrikë do të vijojë të përmirësohet me elementë të rinj, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë objektivit të saj, që është transparenca, aksesi dhe përpunimi nga publiku në kohë reale i informacionit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të AMF-së.

## Tregu i kapitaleve

Tregu i aksioneve mbetet ende i pazhvilluar. Edhe viti 2009 nuk shënoi ndonjë ngjarje të re për zhvillimin e aktivitetit në Bursë. Listimi i shoqërive dhe tregtimi i aksioneve në Bursë, mbetet një përpjekje potenciale. Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të Bursës së Tiranës për të afruar biznesin vendas, faktorë të shumtë si madhësia e bizneseve (kryesisht biznes i vogël dhe i mesëm), mënyra e funksionimit të biznesit, trashëgimia kulturore dhe mentaliteti, kriza financiare ndërkombëtare, kanë ndikuar në moszhvillimin e tregut të kapitalit. Nga ana tjetër, interesimi i subjekteve të huaja për zhvillimin e aktivitetit të Bursës, apo për zhvillimin e aktivitetit të ndërmjetësimit, janë tregues optimistë për zhvillimin e tregut të kapitalit.

Në mungesë të një tregu të organizuar, aksionet vazhdojnë të tregtohen mes aksionarëve duke regjistruar ndryshimin e pronësisë në regjistrat e shoqërive aksionare. Nga ana tjetër shoqëritë e dala nga privatizimi dhe të regjistruara në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, transaksionet mes aksionarëve i regjistrojnë pranë kësaj Qendre. Tendenca e vërejtur në vitet e fundit është ajo e konsolidimit të pronësisë në shoqëritë e privatizuara dhe kjo ka rezultuar në uljen e numrit të transaksioneve në aksione për këto shoqëri nga viti në vit.

"Qendra e Regjistrimit të Aksioneve" është shoqëri aksionare, që zotërohet në masën 85% nga shteti shqiptar. Kjo shoqëri është licencuar nga AMF si regjistër i aksioneve. Përveç regjistrimit të pronësisë së kompanive në formë elektronike (Book-Entry), QRA ofron edhe shërbime të tjera për shoqëritë e regjistruara. Në fund të vitit 2009, QRA numëron 51 shoqëri aksionare të regjistruara.



**Tabelë 13: Statistika mbi transaksionet e regjistruara në QRA për vitin 2009**

| Nr. | Klasifikimi | Statistika |
|---|---|---|
| 1. | Nr. Total i shoqërive aksionare të regjistruara pranë QRA-së | 51 |
| 2. | Nr. Total i aksioneve të shoqërive të regjistruara prënë QRA-së | 23,622,165 |
| 3. | Nr. Total i shoqërive, aksionet e të cilave janë tregtuar | 24 |
| 4. | Nr. Total i transaksioneve të ekzekutuara gjatë vitit 2009 | 369 |
| 5. | Nr. Total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2009 | 2,273,704 |
| 6. | Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2009 | 9.60% |

*Burimi: Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve*

Gjatë vitit 2009, QRA ka reflektuar në regjistrat e aksioneve të shoqërive aksionare 369 transaksione, krahasuar me 494 transaksione të kryera në vitin 2008. Numri i aksioneve të tregtuara jashtë tregut të organizuar gjatë vitit 2009, përbën rreth 9,6% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA, çka tregon se likuiditeti vazhdon të mbetet i ulët.

**Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA)**

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve vepron me licencë që nga viti 2002 me objekt regjistrimin e aksioneve të shoqërive aksionare. Në mbështetje të nenit 6, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Per titujt", Titujt regjistrohen në qendrat e specializuara për mbajtjen e regjistrave të titujve, që organizohen në përputhje me ligjin, dhe licencohen nga Autoriteti, për të ushtruar veprimtari si regjistrarë të titujve.

QRA, krahas mbajtjes së regjistrit, ofron edhe shërbime të tjera si:

- njoftimi i mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së aksionarëve
- llogaritja e dividentëve
- konfirmimi i gjendjes së azhornuar në çdo kohë të llogarisë së secilit aksionar

# II.3 Tregu i pensioneve private vullnetare

## Zhvillimi i tregut të pensioneve private vullnetare

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2009, shihet një rritje prej 37.26% e kontributeve dhe një rritje prej afër 14.71% e numrit të kontribuesve, krahasuar me vitin 2008.

Zhvillimi më i rëndësishëm në këtë treg për vitin 2009, ka qenë hyrja në fuqi e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", i cili sjell përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara. Kuadri ligjor në fushën e pensioneve private paraqitej i vjetëruar me Ligjin nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", i cili nuk përshtatej me standardet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane.

Ligji i ri ka për qëllim përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare private në Shqipëri me ndikime të pritshme:

- lehtësim në planin afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- shtimin e nivelit të kursimit të popullatës dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private:

**Tabelë 14: Tregu i Pensioneve Private Vullnetare 2008 - 2009 (kontribute)**

| Shoqëria | Kontribute (në lekë) | | Ndryshimi (në %) | Pjesa ndaj Totalit (në %) | |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti | 2008 | 2009 | `09/`08 -1 | 2008 | 2009 |
| Raiffeisen PENSIONS | 33,314,145 | 39,420,560 | 18.33 | 62.66 | 54.02 |
| Capital | 8,278,100 | 19,522,151 | 135.83 | 15.57 | 26.75 |
| Sigma IPP | 11,570,162 | 14,025,862 | 21.22 | 21.76 | 19.22 |
| **TOTAL** | **53,162,407** | **72,968,573** | **37.26** | **100.00** | **100.00** |

**Tabelë 15: Tregu i Pensioneve Private Vullnetare 2008 - 2009 (kontribues)**

| Shoqëria | Numri i Kontribuesve | | Ndryshimi (në %) | Pjesa ndaj Totalit (në %) | |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti | 2008 | 2009 | `09/`08 -1 | 2008 | 2009 |
| Raiffeisen PENSIONS | 1,641 | 1,679 | 2.32 | 42.50 | 37.91 |
| Capital | 1,542 | 1,774 | 15.05 | 39.94 | 40.05 |
| Sigma IPP | 678 | 976 | 43.95 | 17.56 | 22.04 |
| **TOTAL** | **3,861** | **4,429** | **14.71** | **100.00** | **100.00** |



## Perspektivat e zhvillimit të sektorit financiar jo-bankar

Përafrimi i legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, strukturimi i zhvillimit të tregjeve sipas standardeve dhe mbrojta e konsumatorit, mbeten objektivat kryesorë, që përbëjnë dhe fokusin e punës së AMF-së në të ardhmen.

Nismat dhe ndryshimet ligjore të viteve të fundit, në të tre tregjet nën juridiksionin e AMF-së, përbëjnë hapa cilësorë në drejtim të përafrimit të standardeve rregullative me ato të Bashkimit Evropian, hapësirave për zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve financiare jo-bankare, si dhe në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Përmirësimi i raportimit dhe futja në zbatim e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, shënon një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë së raportimit dhe përpunimit të informacionit, duke rritur për rrjedhojë cilësinë e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare.

Reformat ligjore, përmirësimi i standardeve dhe rritja e cilësisë së mbikëqyrjes, pritet të kenë ndikim pozitiv në rritjen e interesit të investitorëve të huaj prestigjiozë për tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri.

Tendencat globale të largimit nga mbikëqyrja tradicionale drejt asaj me bazë risku, janë përkrahur nga AMF dhe janë përkthyer në një punë intensive me mbështetjen e Bankës Botërore, për të kaluar në një mbikëqyrje më efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri, në fokus të së cilës do të jetë risku dhe për rrjedhojë përdorimi më efikas i burimeve të kufizuara.

Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit është një element kyç në përmbushjen e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës të AMF-së. Forcimi i mëtejshëm dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit, do të jenë në fokusin e vazhdueshëm të AMF-së për periudhat në vijim.

Fushatat edukuese dhe nxitëse për publikun, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në linjë me rritjen e cilësisë së instrumentave për mbrojtjen e konsumatorit, kanë qenë dhe do vijojnë të jenë objektiva strategjikë të AMF-së, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve financiare jo-bankare.

Të gjitha këto zhvillime cilësore, i hapin rrugën sfidave përherë e më të mëdha që karakterizojnë një treg dinamik e në zhvillim si Shqipëria, sfida të cilat përballohen me strategji të qarta, staf të kualifikuar dhe komunikim proaktiv me aktorët e tregut.

# SHTOJCA A
# Struktura e AMF



# SHTOJCA B
# Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin financiar jo-bankar



## Në Fushën e Sigurimeve

| Referenca Ligjore/Rregullative | Emërtimi | Përshkrimi i Ligjit/Rregullores |
|---|---|---|
| Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 | Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime. | Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj. |
| Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009 | Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit | Qëllim i këtij ligji është përmirësimi i bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm. Ky zhvillim ligjor ndërmerret në një kohë kur tregu i sigurimeve ka avancuar me shpejtësi dhe kërkohen ndryshime ligjore në përgjigje të këtij zhvillimi, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare. |
| VKM nr. 5, datë 07.01.2009, propozuar me vendim Bordi nr. 166, datë 23.12.2008 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 96, datë 03.08.2008 të Këshillit të Ministrave "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit | Ndryshimet në VKM nr. 96, datë 03.08.2008, kanë për qëllim rritjen e kufirit të sipërm të lejueshëm për investimin e provigjoneve teknike e matematike në toka dhe ndërtime, i cili do të jetë në masën 30 përqind, nisur dhe nga mundësitë e kufizuara të investimit brenda vendit. |
| VKM nr. 96, datë 03.02.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 18.06.2007 | Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit | Ky Vendim i Këshillit të Ministrave, përcakton mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike si pjesën më të rëndësishme të përgjegjësive të një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar detyrimet e tyre që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit. |
| VKM nr. 79, datë 28.01.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 4, datë 30.08.2007 | Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, si dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës | Ky Vendim i Këshillit të Ministrave, përcakton kriteret dhe procedurat për licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe në kriteret për licencimin e aktivitetit të agjentit në sigurime. |
| VKM nr. 164, datë 28.01.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 30.08.2007 | Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime | Ky Vendim i Këshillit të Ministrave, parashikon dispozita të përgjithshme, ku krahas karakteristikave të licencës përcaktohen kufizime lidhur me aktivitete të tjera dytësore që mund të ushtrojë vlerësuesi, të cilat sipas projektit duhet të jenë vetëm ato që ushtrohen në pajtim me natyrën e profesionit të tij. |
| VKM nr. 403, datë 09.06.2005 | Për caktimin e komisioneve për përballimin e shpenzimeve të shqyrtimit dhe korrespondencës për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve | Qëllimi i këtij vendimi është caktimi i komisioneve për përballimin e shpenzimeve të shqyrtimit dhe korrespondencës për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe subjektet përkatëse. |
| VKM nr. 268, datë 28.04.2005 | Mbi përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit | Përcaktohen kufijtë maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit. |

| | | |
|---|---|---|
| VKM nr. 191, datë 25.03.2005 | Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë | Në vendim përcaktohet mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë. |
| Udhëzim miratuar me vendimin nr. 11, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF-së | Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore | Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit dhe për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmshpërblimeve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera, përcaktimin e rregullave për dhënien e informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë se kontratës së sigurimit. |
